


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5819
E premte, 5 korrik 2019
çmimi 0.40 €

I jepet lamtumira e fundit veprimtarit Gani Sylaj

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI ■ FAQE 4-5



Kosova të vendosë një linjë buxhetore për ta ndihmuar Luginën

Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), njëherësh kryetar i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka shprehur optimizëm se Kuvendi i Kosovës në ditët e ardhshme do të marrë një vendim për t'i ndihmuar shqiptarët e kësaj pjese. Ai ka thënë se ky vendim

duhet jetë i realizueshëm dhe të ketë efekt të drejtpërdrejtë në tri komunitat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kamberi ka deklaruar se shteti i Kosovës duhet të vendosë një linjë buxhetore për ta ndihmuar Luginën e Preshevës. Ai ka theksuar se drejtue-

sit politikë të Luginës nuk dëshirojnë as të besojnë se kjo temë po bëhet për një luftë të brendshme politike në Kosovë. Sipas Kamberit, çështja e Luginës duhet të trajtohet në dialogun me Serbinë në mënyrë që të gjendet zgjidhje për të drejtat e shqiptarëve

Për Ditën e Pavarësisë, ShBA-ja përruron objektin e ri të ambasadës në Prishtinë

Në 243-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së) liderët institucionale të Kosovës e kanë uruar popullin amerikan. Me rastin e 4 Korrikut ata e kanë falënderuar shtetin më të fuqishëm në botë për ndihmën që i ka dhënë Republikës së Kosovës. Sipas tyre, kjo datë është e madhe jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për të gjithë popujt e botës që besojnë në të drejtat dhe lirinë njerëzore. Me rastin e kësaj date, të enjten është bërë edhe përrurimi i objektit të ri të Ambasadës Amerikane në Prishtinë ■ FAQE 7



INTERVISTË ME BARDHYL MAHMUTIN, DREJTUESIN E QENDRËS "GJENOCIDI NË KOSOVË, PLAGË E HAPUR"



Gjenocidi, krimi që duhet të ndriçohet, njihet dhe ndëshkohet

FAQE 8

AKTUALE



KËRKOHEK QË DIALOGU ME SERBINË TË UDHËHIQET NGA KRYEMINISTRI F. 3

NËNSHKRUHET UDHËZIMI PËR LEHTËSIME DOGANORE DHE TATIMORE PËR INVALIDËT E LUFTËS F. 3

PA NJË GJYQËSOR TË PAVARUR NUK KA ANËTARËSIM TË BALLKANIT NË BE F. 2

EKONOMI

MINISTRI SHALA NË SAMITIN E BALLKANIT PËRËNDIMOR FTON INVESTITORËT E HUAJ TË INVESTOJNË NË KOSOVË F.9

FILLOJNË PARAPËRGATITJET PËR FUSHATËN E KORRJE-SHIRJEVE F.9



KULTURË

EJUPI: SOT VENDOSËT E ARDHMJA E MIREL JOSËS

F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Pa një gjyqësor të pavarur nuk ka anëtarësim të Ballkanit në BE

Zyrtarë të lartë të Unionit kanë thënë, në samitin që po mbahet në Poloni, se asnjë vend i Ballkanit Perëndimor nuk do të hyjë në BE derisa nuk është i gatshëm për të dhe përderisa nuk ka një gjyqësor të pavarur

PRISHTINË, 4 KORRIK - Vendet e Ballkanit Perëndimor janë duke lëvizur në drejtimin e duhur, por shumë ngadalë, dhe qytetarët janë të lodhur për shkak se ata nuk e shohin perspektivën e përparimit të shpejtë drejt BE-së, u tha të enjten në hapjen e Samitit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, në Poznan të Polonisë, që mbahet në kuadër të Procesit të Berlinit. Polonia aktualisht kryeson procesin e Berlinit, i projektuar për t'i rigjallëruar lidhjet midis Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së. Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit Evropian për Politikën e Fqinjësisë dhe negociatave të zgjerimit, Genoveva Ruiz Calavera, tha se asnjë vend nuk

do të hyjë në BE derisa nuk është i gatshëm për të dhe përderisa nuk ka një gjyqësor të pavarur. Ministri i Jashtëm polak, Jacek Czaputowicz, ka bërë thirrje për bashkëpunim më të fuqishëm midis Bashkimit Evropian dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke thënë se kjo do të ndihmojë në rritjen e stabilitetit dhe zhvillimit të rajonit, ka njoftuar rfe. "Evropa nuk mund të konsiderohet plotësisht e bashkuar pa Ballkanin Perëndimor si në aspektin gjeografik, po ashtu edhe në atë gjeopolitik, dhe një politikë ambicioze e zgjerimit të BE-së është vendimtare", tha Czaputowicz. Ndërkaq zëvendësministri i Jashtëm i Polonisë, Szymon Szynkowski vel Sek, para fillimit të konferencës shprehu

shpresën se pjesëmarrësit do të merren vesh që në tetor t'i fillojnë negociatat për anëtarësimin në BE me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Muajin e kaluar shtetet anëtare të BE-së shtynë një vendim për hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë deri në tetor. Disa anëtarë të bllokut, duke përfshirë Francën dhe Holandën, ishin kundër hapjes së negociatave. Komisioni Evropian, si institucion ekzekutiv i bllokut, ka rekomanduar që bisedimet e pranimit me dy vendet e Ballkanit të fillojnë sa më shpejt që të jetë e mundur, duke thënë se të dyja vendet kanë kryer reforma. Mbledhjes së ministrave të jashtëm, të brendshëm dhe të ekonomisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor do t'u bashkohet, më 5 korrik, krerët e BE-së, duke përfshirë kancelaren gjermane Angela Merkel, kryeministren britanike në largim Theresa May, kryeministrin francez Edouard Philippe

dhe presidentin polak Andrzej Duda. Procesi i Berlinit, një iniciativë diplomatike e kancelares gjermane, Angela Merkel, filloi në vitin 2014 me qëllim për të mbështetur një të ardhme paqësore, të qëndrueshme dhe demokratike të Ballkanit Perëndimor si dhe për ta përmirësuar bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian të rajonit. Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Ekrem Mustafa, po merr pjesë në Samitin e Ballkanit Perëndimor. Duke folur për luftimin e korrupsionit, për të cilin u bë fjalë në sesionin e tretë të takimit të ministrave të brendshëm, Mustafa përmendi faktin se Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë e re kundër korrupsionit dhe planin e veprimit 2018-2022. Ministri Mustafa u shpreh se mosanëtarësimi i Kosovës në të gjitha mekanizmat e sigurisë po paraqet jo rrallë vështirësi për autoritetet e sigurisë në Kosovë. Anëtarësimin në Bashkimin

Evropian e përkrahin 56 për qind të qytetarëve dhe 64 për qind e kompanive në Ballkanin Perëndimor, thuhet në rezultatet e hulumtimit "Barometri i Ballkanit" të realizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC). Duke prezantuar rezultatet, në kuadër të Samitit të BE-së me Ballkanin Perëndimor që po mbahet në Poznan të Polonisë, sekretarja e përgjithshme e Këshillit, Majlinda Bregu, tha se për herë të parë, pas pesë vjetësh, më shumë se gjysma e qytetarëve të anketuar e përkrahin integrimin evropian të rajonit. Në hulumtimin e vitit 2015 anëtarësimin në BE e kishin përkrahur 42 për qind e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor. Barometri i Ballkanit është hulumtim i opinionit publik që e kryen RCC-ja, duke mbledhur dhe analizuar të dhënat nga qytetarët dhe kompanitë e Ballkanit Perëndimor në tematika të tilla si punësimi, tregtia, investimet, korrupsioni etj.



Sot vendoset nëse Zaevi do ta drejtojë edhe Ministrinë e Financave



SHKUP, 4 KORRIK - Këshilltarët juridikë në qeveri do ta dorëzojnë bazën juridike me të cilin do të përcaktohen kompetencat e kryeministrit Zaev gjatë udhëheqjes së Ministrinë së Financave. Do të tregojnë edhe cilat do të jenë kompetencat e zëvendësministres Shirete Elezi. Zaev pohon se qëllimi i tij është t'i miratojë vetëm vendimet e

mëdha për financimin e shtetit, ndërsa zëvendësja është ajo e cila do ta udhëheqë dikasterin për vendimet që ai do t'i delegojë. "Të enjten do të duhej të ketë seancë të qeverisë dhe këshilltarët juridikë të qeverisë e propozojnë zgjidhjen me të cilin qeveria bart të drejtën e udhëheqjes së përkohshme të kryeministrit me Ministrinë e Financave deri në

emërimin e ministrit të ri. Këtu e përfundojmë tërë procesin formal-juridik të bartjes së kompetencave, kompetencave të marra, firmosjen e llogarive dhe gjithçka", tha Zoran Zaev. Për dy javë, siç tha Zaev, do të dihet saktë kur do të ketë rishikim të buxhetit që u paralajmërua qysh në pranverë për shkak të realizimit të dobët të

investimeve kapitale. Tek në vijim do të bëhen analiza në të gjitha ministritë dhe sektorët për t'u parë ku duhet të shtohen e ku të shkurtohen mjetet. "Një miliard e gjysmë i kemi planifikuar për gazifikimin dhe nëse nuk projektojmë mjete shtesë, deri në tetor-dhjetor do të ngelim pa para për realizimin e gazifikimit", tha Zaev.

Shoqëria civile dhe subjektet opozitare janë deklaruar pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror për procesin e dialogut

Kërkohet që dialogu me Serbinë të udhëhiqet nga kryeministri

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, dialogu me Serbinë duhet të udhëhiqet nga kryeministri i vendit. Kjo është kërkesa e shoqërisë civile dhe e subjekteve opozitare. Përfaqësuesit e KDI-së dhe të LDK-së kanë vlerësuar të enjten se aktgjykimi i Kushtetueses lidhur me Ligjin për dialog shënon një pikë kthese në procesin e dialogut. Sipas tyre, përmes këtij aktgjykimi janë hequr të gjitha dilemat lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kushtetuese në fushën e politikës së jashtme

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 KORRIK - Shoqëria civile dhe opozita kanë kërkuar që pas aktgjykimit të Kushtetueses, i cili delegacionin shtetëror për dialog me Serbinë e ka shpallur jokushtetues, procesin e dialogut duhet ta udhëheqë kryeministri i vendit. Sipas tyre, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit për delegacionin shtetëror shënon një pikë kthese në procesin e dialogut.

Në një konferencë për medie, Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka thënë se Kushtetuesja ka hequr të gjitha dilemat lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve kushtetuese në fushën e politikës së jashtme. "Pas kontestimit të Ligjit në Gjykatën Kushtetuese nga dy partitë opozitare, LDK-së dhe LV-së, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese qartazi përcaktoi që kompetencat e institucioneve kushtetuese nuk mund t'iu barten 'mekanizmave të posaçëm' të cilat nuk janë të parapara me Kushtetutë. Aktgjykimi konstatoi që ligji, si i tillë, cenon parimin e ndarjes së pushtetit, vlerat demokratike të qeverisjes, ushtrimin e kompetencave të Kuvendit, të qeverisë dhe kryeministrit në sferën e politikës së jashtme", ka thënë ajo.

Sipas Krasniqit, para votimit të ligjit në Kuvend, KDI-ja ka

ndarë me deputetët e Kuvendit një analizë të këtij ligji ku kishte ngritur çështjet lidhur me ndarjen e pushteteve, hierarkisë institucionale si dhe mangësi të tjera të cilat shoqëronin këtë ligj. "KDI-ja ka kërkuar në vazhdimësi që spektri politik të arrijë konsensus lidhur me çështjen e dialogut, duke mirëpritur nismat e ndërmarra në këtë drejtim të cilat kthenin diskutimin në Kuvendin e Kosovës. Ky unitet i spektrit politik nuk arriti të formalizohej as pas përpjekjeve nëpërmjet krijimit të delegacionit shtetëror në dhjetor të vitit të kaluar", ka thënë Krasniqi.

Rreth gjashtë muaj pas themelimit të delegacionit shtetëror, Krasniqi ka theksuar se mund të konkludohet që funksionimi dhe roli i tij ka qenë në suaza marginale si në arritjen e konsensusit të brendshëm, po ashtu edhe në përfaqësimin e Kosovës në planin e jashtëm.

Roli i delegacionit ka qenë i kufizuar vetëm në mbajtjen e takimeve koordinuese me krerët institucionalë të vendit apo takimeve informuese me zyrtarë të ndryshëm të faktorit ndërkombëtar, si dhe përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në Kosovë. "E tërë periudha e funksionimit të delegacionit shtetëror ka qenë e shoqëruar me mungesë të theksuar të transparencës dhe llogaridhënies karshi Kuvendit, shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi. Praktika e



jotransparencës është vërejtur edhe sa iu përket shpenzimeve dhe punësimeve në delegacion, përkatësisht në administratën e tij, për të cilat qeveria kishte ndarë mjete në vlerë prej 300 000 eurosh", është shprehur ajo. Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se dialogu duhet të udhëhiqet nga qeveria dhe të mbikëqyret nga Kuvendi. "Kosova ka humbur dy vjet të plota me ndërhyrjet jokushtetuese të presidentit dhe qeverisë përmes ekipit dialogues në procesin e dialogut. Krejt kjo ka ndodhur për shkak se kryeministri ka abstenuar nga kompetencat kushtetuese duke tentuar t'i bartë kompe-

tencat fillimisht te presidenti përmes draftplatformës që kryeministri e solli në Kuvend në prill të 2018-s, e pastaj tek ekipi dialogues përmes platformës dhe ligjit jokushtetues për dialog", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se dialogu udhëhiqet vetëm nga institucionet që kanë kompetenca kushtetuese për ta përfaqësuar Kosovën në çështje të tilla. "Kushdo tjetër që ndërhyrë në këtë proces bën shkelje kushtetuese siç ka bërë koalicioni PAN përmes ekipit dialogues dhe siç po bën çdo ditë presidenti. LDK-ja mbetet e vendosur për këtë çështje. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

na ka dhënë plotësisht të drejtë se dialogu udhëhiqet nga qeveria me mbikëqyrje të Kuvendit. Presidenti ka vetëm rol konsultativ. Ne besojmë se dialogu duhet të udhëhiqet vetëm nga qeveria që është legjitime, bazuar në platformë që bazohet në Kushtetutën e Kosovës dhe që miratohet nga 2/3 e votave të deputetëve", ka shkruar Hoti.

Pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror për procesin e dialogut, PSD-ja është larguar nga ky delegacion dhe rrjedhimisht ky mekanizëm është bërë i padobishëm.

Nënshkruhet udhëzimi për lehtësime doganore dhe tatimore për invalidët e luftës



PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka nënshkruar të enjten Udhëzimin Administrativ MF-NR. 003/2019 për procedurat e realizimit të drejtave në lehtësimet doganore dhe tatimore për invalidët e luftës.

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe kushteve të realizimit të drejtave për lirim nga

detyrimet importuese për kategorinë e invalidëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në bazë të këtij udhëzimi pjesëtarët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët e kanë statusin e invalidit të luftës të njohur nga institucionet e Republikës së Kosovës, me shkaqet e invaliditetit nga grupi një deri në shtatë, lirohen nga çdo lloj tatiimi dhe taksë doganore për

importimin e veturës speciale dhe pajisjeve ortopedike për përdorim personal të invalidit të luftës.

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ministria e Financave do t'i vazhdojë edhe më tutje reformat në politikën fiskale me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Shaip Kamberi

Kosova të vendosë një linjë bux



Kryetari i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), njëherësh kryetar i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi, ka shprehur optimizëm se Kuvendi i Kosovës në ditët e ardhshme do të marrë një vendim për t'i ndihmuar shqiptarët e kësaj pjese. Ai ka thënë se ky vendim duhet jetë i realizueshëm dhe të ketë efekt të drejtpërdrejtë në tri komunat. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kamberi ka deklaruar se shteti i Kosovës duhet të vendosë një linjë buxhetore për ta ndihmuar Luginën e Preshevës. Ai ka theksuar se drejtuesit politikë të Luginës nuk dëshirojnë as të besojnë se kjo temë po bëhet për një luftë të brendshme politike në Kosovë. Sipas Kamberit, çështja e Luginës duhet të trajtohet në dialogun me Serbinë në mënyrë që të gjendet zgjidhje për të drejtat e shqiptarëve

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kryetari i Komunës së Bujanocit, njëherësh kryetar i Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Shaip Kamberi, ka thënë të enjten se në Kosovë duhet të arrihet një konsensus për zgjidhjen e problemit të Luginës së

Preshevës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se drejtuesit politikë të Luginës nuk dëshirojnë as të besojnë se kjo temë po eksploatohet për një luftë të brendshme politike në Kosovë. "Ne jemi të interesuar që në Prishtinë të krijohet një konsensus politik për Luginën e Preshevës e kursesit që tema

jonë të shërbejë si mollë sherri. Ne dëshirojmë të besojmë në motivet e singerta të gjithsecilit përfaqësues institucional dhe politik në Kosovë se për Luginën e Preshevës duhet gjetur zgjidhje", është shprehur ai, duke shtuar se çështja e Luginës duhet të trajtohet në dialogun me Serbinë dhe të gjendet zgjidhje për të drejtat e

shqiptarëve. "Në radhë të parë Kosova duhet të bëjë angazhim maksimal që çështja e Luginës së Preshevës të jetë pjesë e bisedave me Serbinë. Në këtë dialog duhet përkujtuar Serbisë se edhe ajo ka obligime ndaj shqiptarëve në këtë rajon të cilat po i nëpërkëmbë", ka deklaruar Kamberi.

Ai ka shprehur optimizëm se Kuvendi i Kosovës në ditët në vazhdim do të marrë një vendim për t'i ndihmuar shqiptarët e Luginës dhe, sipas Kamberit, ky vendim duhet jetë i realizueshëm dhe të ketë efekt të drejtpërdrejtë në tri komunat shqiptare. "Respektivisht, në bazë të këtij akti duhet që Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përgjegjëse të zbatojnë pikë për pikë obligimet që dalin nga ky akt juridik", ka thënë ai. Lideri i PVD-së ka thënë se, pavarësisht prej raporteve

komplekse që janë me Serbinë, ekzistojnë mjaft hapësira që duhen shfrytëzuar që ndihma e Kosovës për Luginën e Preshevës të jetë e drejtpërdrejtë dhe efikase. Në këtë kontekst, Kamberi ka theksuar se shteti i Kosovës duhet të vendosë një linjë buxhetore për ta ndihmuar Luginën e Preshevës. "Veç të tjerash, realizimi i projekteve konkrete nga ministrinë përkatëse mund të jetë një formë efikase e ndihmës që duhet adresuar për ne. Shembull i Ministrisë së Drejtësisë me projektin e rinovimit të një shkolle fillore dhe ai i Ministrisë së Financave duhet ndjekur edhe nga ministrinë e tjera. Por, forma më e mirë do të ishte vendosja e një linjë buxhetore për Luginën e Preshevës. Aktivizimi i Fondit për Luginën si produkt i një vendimi të dy qeverive

hetore për ta ndihmuar Luginën

integruar në institucionet shtetërore dhe publike, gjendje kjo e cila shqiptarët i mban në qytetarë të kategorisë së diskriminuar. Problemet në arsim, me mosnjohjen e diplomave, mungesa e teksteve shkollore, refuzimi i përdorimit zyrtar i gjuhës dhe shkrimin në punën e institucioneve shtetërore, ndalimi i përdorimit të simbolit kombëtar dhe pjesëmarrja joadekuade në strukturat e policisë dhe gjyqësorit, janë disa prej sfidave të cilat nuk është arritur të tejkalohen që nga viti 2001 dhe përfundimi i luftës së armatosur.

"Epoka e re": Si e keni parë mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës për gjendjen në Luginë të Preshevës dhe mosmiratimin e një rezolute në mungesë të kuorumit?

Kamberi: Është për t'u përhëndetur seanca e mbajtur dhe fakti që institucioni ligjvënës në Kosovë ka marrë përsipër të debatojë dhe të nxjerrë vendim për Luginën e Preshevës. Na ka zhgënjyer fakti që në mungesë të kuorumit atë ditë edhe nuk u votua ky dokument, edhe pse të gjithë e kemi pritur. Sido që të jetë, nëse Kuvendi do ta votojë këtë dokument në cilëndo formë qoftë, duhet të jetë i realizueshëm.

"Epoka e re": Nëse në ditët në vijim deputetët do të mund ta aprovojnë këtë rezolutë, a prisni që të zbatohet dhe do të ketë efekt kjo rezolutë?

Kamberi: Pas rezolutës së aprovuar disa vjet më parë, e cila mjerisht mbeti vetëm dokument në letër, presim që vendimi i cili do të merret në Kuvendin e Kosovës të jetë edhe i realizueshëm, edhe të ketë efekt të drejtpërdrejtë në rajonin tonë. Respektivisht, në bazë të këtij akti duhet që Qeveria e Kosovës dhe ministrinë përgjegjëse t'i zbatojnë pikë për pikë obligimet që dalin nga ky akt juridik. Mendojmë se, pavarësisht prej raporteve komplekse që janë me Serbinë, ekzistojnë mjaft hapësira që duhen shfrytëzuar që ndihma e Kosovës për Luginën e Preshevës të jetë e drejtpërdrejtë dhe efikase.

"Epoka e re": Cila është forma më e mirë që Kosova, por edhe Shqipëria, t'i ndihmojnë shqiptarët e Luginës së Preshevës?

Kamberi: Në radhë të parë Kosova duhet të bëjë angazhim maksimal që çështja e Luginës së Preshevës të jetë pjesë e bisedave me Serbinë. Në këtë

dialog duhet përkujtuar Serbisë se edhe ajo ka obligime ndaj shqiptarëve në këtë rajon të cilat po i nëpërkëmbë. Veç të tjerash, realizimi i projekteve konkrete nga ministrinë përkatëse mund të jetë një formë efikase e ndihmës që duhet adresuar për ne. Shembulli i Ministrisë së Drejtësisë, me projektin e rinovimit të një shkolle filllore dhe ai i Ministrisë së Financave, duhen ndjekur edhe nga ministrinë e tjera. Por, forma më e mirë do të ishte vendosja e një linjë buxhetore për Luginën e Preshevës. Aktivizimi i Fondit për Luginën si produkt i një vendimi të dy qeverive

(Prishtinë e Tiranë) nga mbledhja e Prizrenit është mundësi në vete për ta ndihmuar Luginën e Preshevës.

"Epoka e re": Në ditën kur është mbajtur debati i jashtëzakonshëm në Kuvend, presidenti Thaçi u ka propozuar për miratim deputetëve një rezolutë e cila, përveç kërkesës për bashkimin e Luginës së Preshevës me Kosovën, parasheh që çështja e Luginës të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi si dhe përfaqësuesi i saj të jetë pjesë e delegacionit të bisedimeve. Do të ndodhë një gjë e tillë apo do të mbetet thjesht vetëm një

deklaratë politike?

Kamberi: Ne jemi të interesuar që në Prishtinë të krijohet një konsensus politik për Luginën e Preshevës e kurrsesi që tema jonë të shërbejë si mollë sherri. Çastet aktuale dhe arritja e një marrëveshje eventuale me Serbinë duhen shfrytëzuar nga Kosova që Luginë e Preshevës të trajtohet në këtë dialog dhe të gjendet zgjidhje për të drejtat e shqiptarëve. Nuk dëshirojmë as të besojmë se kjo temë po eksploatohet për një luftë të brendshme politike në Kosovë. Ne dëshirojmë të besojmë në motivet e sinqerta të gjithsecilit përfaqësues institucional e politik në Kosovë se për Luginën e Preshevës duhet gjetur zgjidhje.

Ministri Ismaili përruron pajisjet moderne në Kirurgjinë Maksillofaciale

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 4 korrik - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të enjten Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale, ku ka përruruar pajisjet e reja të cilat janë blerë për këtë klinikë. Për herë të parë, që nga themelimi i saj më 1983, kjo klinikë është pajisur me një Ortopan 3-Dimensional të teknologjisë së fundit.

Shërbimet që janë kryer deri sot nga qytetarët në institucione private, si rëntgeni i kockave të fytyrës, kokës dhe dhëmbëve, nga tani mund të realizohen në QKUK, me imazhe shumë më të avan-

cuara.

Ministri Ismaili ka thënë se këto investime po bëhen në vazhden e shtimit të shërbimeve mjekësore në institucionet publike shëndetësore. "Interesi ynë kryesor janë pacientët. Të gjitha këto investime që po bëjmë janë për ta ndalur keqtrajtimin e tyre nga një klinikë në tjetrën, por edhe për ta ruajtur xhepin e tyre. Sot është një ditë e lumtur për të parë sa kësaj klinike, këtyre profesionistëve shëndetësorë, po u shtohet edhe një shërbim i ri, i munguar prej kohësh", ka thënë ministri Ismaili.

Më tej, ministri Ismaili ka theksuar se gjatë këtij viti do të blihen edhe shumë pajisje të tjera

për t'i avancuar shërbimet mjekësore për qytetarët tanë. Mjeku specialist i kësaj klinike, Shkëlzen Komoni, ka pohuar se në mungesë të kësaj pajisjeje ata shpeshherë janë detyruar t'i kthejnë pacientët pa i marrë shërbimet e nevojshme mjekësore. "Nga viti 1983, kur është themeluar kjo klinikë, ne nuk e kemi pasur një pajisje të tillë. Tani do të jemi në gjendje t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave të qytetarëve për këto lloj shërbimesh", ka thënë ai. Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka bërë me dije se po punohet çdo ditë që sistematikisht në të gjitha klinikat të ketë shtim dhe përmirësim të shërbimeve shëndetësore.



(Prishtinë e Tiranë) nga mbledhja e Prizrenit është mundësi në vete për ta ndihmuar Luginën e Preshevës", është shprehur Kamberi.

"Epoka e re": Z. Kamberi, si është gjendja e shqiptarëve në Luginë të Preshevës dhe cilat janë problemet kryesore me të cilat po ballafaqoheni aktualisht?

Kamberi: Në Luginë të Preshevës vazhdon diskriminimi shtetëror i Serbisë mbi të drejtat elementare të shqiptarëve. Përkundër tri marrëveshjeve të nënshkruara që kishin për qëllim përmirësimin e pozitës së shqiptarëve, refuzimi i Beogradit për t'i implementuar po e mban këtë rajon në rrethana të jashtëzakonshme. Qeveria qendrore në vazhdimësi po injoron kërkesën e shqiptarëve për t'u

I jepet lamtumira e fundit veprimtarit Gani Sylaj

Të enjten në fshatin Kizharekë të Drenasit i është dhënë lamtumira e fundit veprimtarit të çështjes kombëtare, Gani Sylaj, i cili ka ndërruar jetë në moshën 67-vjeçare, pas një sëmundje të rëndë. Po këtë ditë, nën përkujdesjen e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në Prishtinë është mbajtur një mbledhje përkujtimore me rastin e ndarjes nga jeta të Sylajt. Aty u tha se Gani Sylaj është një ndër veprimtarët që ka punuar për idealin e Kosovës



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

DRENAS, 4 KORRIK - Të enjten në fshatin Kizharekë të Drenasit i është dhënë lamtumira e fundit shkrimtarit, veprimtarit të hershëm për çështjen kombëtare, ish-kryetarit dhe nënkryetarit të Komunës së Drenasit, Gani Sylaj, i cili ka ndërruar jetë në moshën 67-vjeçare pas një sëmundje të rëndë.

Të enjten asambleja e Kuvendit Komunal e Drenasit ka organizuar mbledhje përkujtimore, po ashtu në Teatrin Kombëtar të Kosovës janë bërë homazhe dhe është mbajtur tubim përkujtimor në nderim të veprës së tij.

Ngushëllime familjes Sylaj i kanë shprehur liderët e institucioneve të Kosovës, përfaqësues të veteranëve të luftës, kryetarë komunash, veprimtarë të çështjes kombëtare dhe ish të burgosur politik.

Presidenti Hashim Thaçi, duke përmendur veprimtarinë e Gani Sylajt, ka thënë se ai në çdo fazë të veprimtarisë së tij i

ka bashkuar njerëzit dhe ka kontribuar për idealin e Kosovën. "Ganiu ishte njeriu i lëvizjes kombëtare që mendonte sa për Prishtinën, aq për Preshevën, Shkupin, Ulqinin. Mendonte për bashkim kombëtar. Ganiu ishte prej të parëve që e ndihmoi edhe komandant Adem Jasharin", ka thënë presidenti.

Ndërkaq kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka theksuar se e gjithë komuna që ai drejton dhe të gjithë qytetarët janë krenarë për veprimtarinë e Ganiut.

Një prej veprimtarëve, Mehmet Hajrizi, ka shprehur gjithë kontributin për Kosovën të veprimtarit Gani Sylaj, ku tha se ai do të kujtohet ndër breza.

Përfaqësuesi i të burgosurve politikë, Hydajet Hyseni, ka theksuar se kontributi dhe sakrificat e Ganiut ka qenë shumë e rëndësishme për Kosovën. Ndërkaq në emër të familjes të pranishmit i ka falënderuar djali i të ndjerit, Atdhe Sylaj.

Gani Sylaj lindi më 14 janar

1952 në fshatin Kishnarekë, Komuna e Drenasit, ish-Glllogoc. Shkollën fillore e ka nisur në Kishnarekë, ndërsa e ka përfunduar në Komoran. Në Prishtinë ka mbaruar Shkollën e Mesme Normale në vitin shkollor 1971/72. Në vitin 1973 regjistron degën e Filozofisë në Fakultetin Filozofik, të cilin e ndërprente në vitin 1974, kur i përkushtohet tërësisht organizimit ilegal në

grupin revolucionar të Kosovës. Në vitin 1979 burgoset dy muaj për kundërvajtje, në Gjykatën Komonale në Drenas. Pa mbaruar këtë dënim në Burgun e Prishtinës, dërgohet në Burgun e Shkupit, ku në vitin 1980 dënohet me 4 vjet burgim. Fillon vuajtjen e dënimit në Burgun e Idrizovës, në Maqedoni, deri në shkurt të vitit 1982, kur sigurimi jugosllav e transferon në Burgun e

Prishtinës, për ta dënuar me 12 vjet burg, të cilat i mbajti në Burgun e Mitrovicës dhe në Burgun Hetues të Somborit, në Vojvodinë. Nga burgu është liruar në vitin 1990.


Pas burgut, nga viti 1990-1994 ushtron disa funksione dhe merret me një sërë aktivitete: me iniciativën e kolektivit të shkollës fillore të fshatit të lindjes, zgjidhet drejtor i shkollës fillore. Kur u themelua Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë u zgjodh kryetar për Komunën e Drenasit, ndërsa në kuadër të kryesisë së kësaj shoqate ishte i ngarkuar edhe me detyra të tjera: në Lidhjen Demokratike të Kosovës, anëtar i Kryesisë së Degës së Drenasit dhe delegat në kuvendin e saj; në Lëvizjen për Republikën e Kosovës, kryetar; në Këshillin për Financim, anëtar i kryesisë së degës në Drenas dhe anëtar i komisionit të kontrollit në nivel të Këshillit. Një ndër redaktorët e gazetës "Bashkimi" etj.

Pas shpërthimit të parë të Jasharëve, së bashku me shokët e burgut etj., merr pjesë në tërheqjen dhe strehimin e qetës së Adem Jasharit (1991).

Më 1994-2000, pasi i shpëton një ekspedite të policisë serbe, emigron në Zvicër. Fillimisht kryetar i nëndegës së Cyrihut e më vonë kryetar i Degës së LDK-së në Zvicër. Bashkëpunëtor i Ministrisë së Arsimit në mërgim, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Arsimitarëve dhe Pedagogëve Shqiptarë në Zvicër, kryetar i Emergjencës për Zvicër, kryetar i Degës së Lidhjes së Bashkuar Demokratike në Zvicër etj.

Në prill-qershor të vitit 1999, zëdhënës i UÇK-së dhe zëvendëskomandant për Zonën e Veriut; anëtar i Fondit Vendlindja Thërret; më 1999-2000, në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, zëvendësministër i Ministrisë për Emigracion; më 2000-2001 drejtor i Agjencisë së Lajmeve "Kosovapress"; më 2001-2002 ndjek kursin për organizimin e partive politike në kuadër të NDI-së (Instituti Nacional Demokratik).

Gjatë viteve 2002-2005 ishte kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës për Drenas dhe anëtar i Këshillit Drejtues i PDK-së; kryetar i Komunës së Drenasit; i certifikuar për pushtetin lokal në Universitetin Georgetown në Uashington, ShBA (2004); më 2006-2011, drejtues ekzekutiv në Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë; më 2008-2011, anëtar i Bordit të Drejtorëve të PTK-së etj. Nga viti 2017 ka ushtruar detyrën e nënkryetarit të Komunës së Drenasit.



Për Ditën e Pavarësisë, ShBA-ja përruron objektin e ri të ambasadës në Prishtinë

Në 243-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së) liderët institucionalë të Kosovës e kanë uruar popullin amerikan. Me rastin e 4 Korrikut ata e kanë falënderuar shtetin më të fuqishëm në botë për ndihmën që i ka dhënë Republikës së Kosovës. Sipas tyre, kjo datë është e madhe jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për të gjithë popujt e botës që besojnë në të drejtat dhe lirinë njerëzore. Me rastin e kësaj date të enjten është bërë edhe përrurimi i objektit të ri të ambasadës në Prishtinë



ShBA-ja është sinonim i idealeve më të larta të bazuara në vlerat universale të lirisë dhe demokracisë, vlera të cilat ishin vënë në ballë të luftës për çlirim-in e vendit tonë. Kosova do të jetë gjithmonë krah Amerikës në rreshtin e paqes. ShBA-ja, si mishërim i prosperitetit, është shembull që Kosova me krenari e ndjekë, pa u lëkundur", ka shkruar në profilin e tij në "Facebook".

Popullin amerikan e kanë uruar edhe zëvendëskryeministri Behgjet Pacolli dhe Fatmir Limaj. "Urime 4 Korrikun nga Kosova! Kosova dhe ShBA-ja janë aleatë strategjikë. Popujt tanë ka një lidhje të fortë miqësie. Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Amerikës do të zgjerohen më tej, ndërsa ne qëndrojmë së bashku si aleatë. Amerika mbetet aleatja më e besueshme e Kosovës në rrugën tonë për ta konsoliduar shtetin tonë. Urime për ditën e pavarësisë amerikane, ditën që simbolizon edhe lirinë tonë!", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Ndërsa Fatmir Limaj ka thënë se kombi amerikan ngërthen në vete vlerat dhe idealet më civilizuese dhe është mbrojtës dhe promovues i lirisë dhe të drejtave të njeriut si dhe udhërrëfyes për të gjithë popujt dhe botën liri-dashëse. "Në emrin tim dhe të Nismës Socialdemokrate shpreh urimet më të përzemërta për popullin mik amerikan. Qytetarët e Kosovës do t'i jenë përjetë mirënjohës ShBA-së për kontributin dhe ndihmën dhënë për Kosovën në të gjithë etapat. Kosova është e bekuar që ka miqësi me ShBA-në dhe miqësia me të do të jetë e përzemërta", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Liderët e Kosovës kanë uruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës me rastin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së Amerikës. Me këtë rast, ata kanë vlerësuar se kjo datë është e madhe jo vetëm për popullin shqiptar, por edhe për të gjithë popujt e botës që besojnë në të drejtat dhe lirinë njerëzore.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se në çdo 4 korrik Kosova dhe shqiptarët emocionalisht janë bashkë me Amerikën. "Sot është ditëlindja e 243-të e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Çdo 4 korrik Kosova dhe shqiptarët emocionalisht janë bashkë me Amerikën, vend dhe popull ky që kontribuoi shumë që ne të jemi të lirë dhe të pavarur. Ky përvjetor është ndër më të veçantit për Republikën e Kosovës meqë përrurojmë objektin e ri të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, e cila është përjetësim i angazhimit amerikan në vendin tonë. Edhe pas shumë shekujsh ShBA-ja mbetet udhërrëfyes e paqes dhe demokracisë në botë", ka shkruar Thaçi.

Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka shkruar se Kosova është e bekuar që në krah të vet ka kombin e madh amerikan. "4 korriku është një datë e madhe jo vetëm për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe për popullin tonë dhe të gjithë popujt e botës që besojnë në të drejtat dhe lirinë njerëzore. ShBA-ja ka qenë dhe vazhdon të jetë garantuese e vlerave demokratike dhe paqes globale. Kosova është e bekuar që në krah të vet ka kombin e madh amerikan. Festa e sotme është e dyfishtë sepse përrurojmë edhe objektin e ri të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë. Urime të gjithëve, popullit amerikan dhe përfaqësuesve të tij në vendin tonë!", ka shkruar Veseli në profilin e tij në "Facebook". Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se ShBA-ja është sinonim i idealeve më të larta të bazuara në vlerat universale të lirisë dhe demokracisë. "Me rastin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së ShBA-së, ua përcjell urimet më të përzemërta popullit dhe shtetit amerikan.

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 KORRIK - Me rastin e 243-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së), të enjten në Prishtinë Ambasada e ShBA-së ka përruruar objektin e ri. Përrurimin e këtij objekti e bënë ambasadori amerikan Philip Kosnett, kongresisti amerikan Eliot Engel, presidenti Hashim Thaçi dhe kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti.

Kongresisti amerikan Eliot Engel është shprehur i lumtur me përrurimin e ndërtesës së re të

Ambasadës së ShBA-së në Kosovë. "Sot është një ëndërr e cila është bërë realitet. Gjërat e mira mund të ndodhin. Faleminderit ShBA-së që ishit me kosovarët në vitin 1999. ShBA-ja çdoherë do të qëndrojë pranë Kosovës sepse Kosova është pjesë e ShBA-së", ka thënë Engel.

Ndërkaq ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett, është shprehur mirënjohës ndaj Kosovës me rastin e përrurimit të ndërtesës së re të ambasadës. Kosnett në fjalimin e tij ka thënë se ShBA-ja çdoherë do të jetë me Kosovën në secilin rrugëtim të saj.



Fillojnë parapërgatitjet për fushatën e korrje-shirjeve

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim edhe me palët e tjera që ndërlihdhen me këtë proces, kanë bërë parapërgatitjet për fillimin dhe realizimin e fushatës së korrje-shirjeve për vitin 2019. Me qëllim të koordinimit sa më të mirë të punëve, përfaqësuesit e MBPZHR-së kanë mbajtur takimin e përbashkët me përfaqësues të Drejtorive Komunale për Bujqësi, të Shoqatës së Prodhuesve të Grurit dhe përfaqësuesve të Shoqatës së Mullisëve.

Gjatë këtij takimi palët e përfshira në këtë proces janë pajtuar që të mos fillohet me korrje-shirjet para pjekjes së plotë të grurit, e krahas kësaj edhe drejtoritë komunale për bujqësi të raportojnë në MBPZHR, gjegjësisht të komisionit qendror për monitorimin e korrje-shirjeve për vitin 2019, një herë brenda javës lidhur me ecurinë e korrje-shirjeve në komunat e tyre. Me këtë rast, bazuar në çmimin aktual të derivateve të naftës, pjesëve rezervë të autokombajnave si dhe gjendjes së zhvillimit të grunajave, MBPZHR, përfaqë-



suesit e DKB-ve, përfaqësuesit e Shoqatës së Prodhuesve të Grurit dhe përfaqësuesit e Shoqatës së Mullisëve, kanë propozuar që çmimi real i korrje-shirjeve për vitin 2019 do të ishte 100 euro për hektarë (nënkuptohet se çmimi i korrje shirjeve caktohet me marrëveshjen në mes të fermerëve dhe autokombajn-erëve). Ndryshe, në gjithë territorin e Kosovës sivjet me kulturën e grurit janë të mbjellë 50 mijë hektarë, ndërsa MBPZHR-ja i mbështetë kultivuesit e grurit dhe farës së grurit përmes pagesave direkte.

Intervistë me Bardhyl Mahmutin, drejtuesin e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë, plagë e hapur"

Gjenocidi, krimi që duhet të ndriçohet, njihet dhe ndëshkohet



përgatitur një veprimtar i shquar i çështjes kombëtare, që vjen nga Lugina e Preshevës, Adnan Asllani. Për ata që nuk e dinë, Adnan Asllani është autori i emblemës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kryeredaktori i "Zërit të Kosovës" gjatë luftës në Kosovë.

"Epoka e re": A keni përcaktuar modalitetet e përdorimit të logos dhe rastet kur do të duhej të përdorej logoja e lulëkuqes me figurat që simbolizojnë viktimat e gjenocidit në Kosovë?

Bardhyl Mahmuti: Janë një numër idesh të modaliteteve të prezantimit të logos, të cilat do të konkretizohen në një të ardhme shumë të afërt. Mendojmë që ditët e përkujtimeve të viktimave të gjenocidit në nivele lokale janë ditë të veçanta, ku do të mund të përdroreshin logot në shenjë solidariteti dhe përkujtimi, ose më 15 janar, datë të cilën Kuvendi i Kosovës e ka shpallur si Ditë të Përkujtimit të Gjenocidit ndaj Shqiptarëve në Kosovë. Megjithatë, duke u nisur nga ndikimi i madh që kanë manifestimet kulturore dhe sportive në përhapjen e mesazheve të caktuara, përdorimi i logos për ta bërë të njohur gjenocidin serb në nivel ndërkombëtar është plotësisht i arsyeshëm.

"Epoka e re": A mendoni ta zgjeroni rrjetin edhe në vendet e tjera demokratike?

Bardhyl Mahmuti: Shpresojmë që në çdo vend demokratik të botës do të krijohen qendra që do ta japin kontributin e tyre për ta bërë sa më ta njohur gjenocidin e Serbisë në Kosovë. Kjo do të ishte mënyra më e mirë e përkujtimit të atyre që janë plagë e hapur në shpirtin dhe trupin e Kosovës.

EPOKA E RE Lulëzim ETEMAJ

Më 30 qershor 2019, në Bern të Zvicrës, është themeluar Qendra "Gjenocidi në Kosovë, plagë e hapur". Objektivi kryesor i themeluesve është thënë të jetë shndërrimi i kësaj qendre në një rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, profesionistë të profileve të ndryshme, që angazhohen vullnetarisht për ndriçimin e plotë të gjenocidit serb në Kosovë, informimin e drejtë të opinionit dhe këmbëngulin për domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë - dënimin meritor të planifikuesit, urdhërdhënësit dhe zbatuesit të tij, shtetit të Serbisë. Për të sjellë sa më shumë informacion për opinionin publik rreth themelimit, fushëveprimit si dhe objektivit të Qendrës "Gjenocidi në Kosovë, plagë e hapur", e cila ka hasur në një jehonë shumë pozitive, për gazetën "Epoka e re" e intervistuar politologun Bardhyl Mahmuti, të cilit nismëtarët e themelimit ia kanë besuar udhëheqjen e qendrës.

"Epoka e re": Më 30 qershor themeluat Qendrën "Gjenocidi në Kosovë, plagë e hapur". Cilat janë qëllimet e kësaj qendre dhe si mendoni t'i realizoni ato?

Bardhyl Mahmuti: Informimi sa më i madh dhe sa më i gjithanshëm në përmasa botërore lidhur me atë që ka ndodhur gjatë luftës në Kosovë është detyrë e institucioneve të Kosovës, sidomos që nga koha e miratimit nga ana e Kuvendit të

Kosovës të rezolutës për gjenocidin, të datës 8 maj 2019. Qëllimi kryesor i qendrës që kemi themeluar, si organizatë joqeveritare, është ta japim kontributin tonë në këtë drejtim. Shpresojmë të shtrihemi në të gjitha vendet demokratike në botë dhe të krijojmë një rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, të cilët angazhohen vullnetarisht për ta përhapur të vërtetën e gjenocidit serb në Kosovë. Ndriçimi i kësaj tragjedie krijon kushtet që të pranohet dhe të njihet nga vendet demokratike krimi i gjenocidit, që shteti serb e ka kryer kundër shqiptarëve në Kosovë.

"Epoka e re": Me sa shihet, themelimi i qendrës ka ngjallur një interesim të madh?

Bardhyl Mahmuti: Të jemi të qartë. Politika e gjenocidit në Kosovë ka pasur për qëllim t'i shkatërroj shqiptarët si komb, si etni dhe si religjion i ndryshëm nga serbët. Në zbatimin e kësaj politike nuk janë bërë dallimet nëse dikush është i kësaj apo asaj partie, i këtij apo atij rajoni, i kësaj apo asaj gjinie, i kësaj apo asaj moshe: të gjithë shqiptarët e Kosovës kanë qenë cak i shkatërrimit. Prandaj, pa marrë parasysh nga cili shtet kanë prejardhjen apo në cilin shtet jetojnë aktualisht, intelektualët dhe veprimtarët shqiptarë duhet t'i bashkërenditin veprimtaritë e veta që të ngadhënjë drejtësisia.

"Epoka e re": Për logo të qendrës keni përcaktuar lulëkuqen. Lulëkuqja është simbol që është

përdorur edhe nga popuj të tjerë. Cilat janë arsyet që u përcaktuat për këtë logo?


Bardhyl Mahmuti: Është fakt se në disa vende të botës, së paku që një shekull, lulëkuqet kanë shërbyer si simbol për t'i përkujtuar të rënët gjatë luftërave anekënd globit. Kështu, për shembull, në Britaninë e Madhe dhe vendet e Komonvelthit lulëkuqet janë simbol i përkujtimit të luftëtarëve të vrarë në fushëbeteja, veçanërisht të rënëve gjatë Luftës së Parë Botërore dhe solidarizimit me familjet e tyre. Edhe kanadezët e kanë përcaktuar këtë lule si simbol të premtimit, që do t'i përkujtojnë dhe që nuk do t'i harrojnë kurrë ata të cilët u sakrifkuan për lirinë e vendit. Përkujtimi i të rënëve në Kanada bëhet çdo vit në orën 11.00, në ditën e 11 të muajit të 11.

Pas konsultimeve të shumta, vendosëm që simbol i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë, plagë e hapur" të jetë lulëkuqja. Për dallim nga lulëkuqet që përdoren si simbol në shumë vende të tjera, katër petalet e lulëkuqes në logon që kemi krijuar paraqesin katër format e veprimeve të gjenocidit, që Serbia e zbatoi në Kosovë: vrasjet, dhunimet seksuale, spastrimi etnik dhe shkatërrimi i objekteve që lidhen me përkatësinë etnike dhe identitetin shqiptar. Ndërsa në vend të kokrave të zeza të farës së lulëkuqes, në logon tonë janë prezantuar figura burrash, grash, djemsh dhe vajzash, për të kujtuar mbi dhjetë mijë civilë shqiptarë të vrarë dhe të gjymtuar, të të gjitha moshave dhe të dy gjinive,

mbi njëzet mijë viktime të dhunës seksuale, rreth një milion viktime të spastrimit etnik dhe qindra mijëra shkatërrime gjatë gjenocidit në Kosovë. Petalet e lulëkuqes në logon tonë janë të vendosura në formë të shkronjës X, për arsye se gjatë luftës, në disa vendbanime ku popullsia ishte e përzier në aspektin e përkatësisë etnike, okupatorët serbë kishin shënjuar shtëpitë e shqiptarëve me një X, me qëllim që të udhëzoheshin forcat e armatosura serbe drejt vendeve ku duhej të kryeshin krimet.


"Epoka e re": Kush e përgatiti logon e Qendrës?

Bardhyl Mahmuti: Logon e ka



Auditori i Përgjithshëm viziton Parlamentin e Japonisë, Bashkinë e Tokios dhe Bordin e Auditimit

TOKIO, 4 KORRIK (ER) - Në kuadër të vizitës në Tokio të Japonisë, auditori i përgjithshëm Besnik Osmani dhe zëvendësauditori i përgjithshëm, Ilir Salihu, të shoqëruar nga ambasadori i Kosovës në Japoni, Leon Malazogu, kanë zhvilluar takime të veçanta në Parlamentin e Japonisë, Bashkinë e Tokios dhe Bordin e Auditimit të Japonisë. Në Parlamentin e Japonisë, auditori i përgjithshëm u prit në një takim të veçantë nga kryetari i Komisionit për Auditim dhe Mbikëqyrje të Administratës, Banri Kaieda. Në takim u bisedua për rëndësinë e auditimit të jashtëm në menaxhimin e mirë të fondeve publike, me theks të veçantë për bashkëpunimin në mes të parlamenteve dhe institucioneve supreme të auditimit, sidomos në rolin e parlamentit në zbatimin e rekomandimeve



të auditimit, me qëllim të përmirësimit të qeverisjes dhe menaxhimit më të mirë të parasë publike. Ndërsa në takimin e mbajtur në bashkinë e Tokios, auditori i përgjithshëm u prit nga drejtori i përgjithshëm i Sekretarisë për Auditim dhe Inspektim të

Tokios si dhe përfaqësues nga komiteti i auditimit. Temë e këtij takimi ishte roli, mandati organizimi, llojet e auditimit dhe inspektimit që kryhen nga ky institucion në subjektet publike të Tokios. U biseduan çështje me interes për palët, ndërsa praktikat e

veprimit dhe masat korrigjuese që ndërmerren nga institucionet japoneze, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve, u vlerësuan si një mekanizëm i qëndrueshëm dhe i rëndësishëm për ta rritur përgjegjësinë për menaxhimin e fondeve publike.

Po ashtu, u bisedua për përgatitjet për auditimin e fondeve për Olimpiadën "Tokyo 2020" dhe mundësitë që auditorët kosovarë të përfitojnë njohuri të reja nga kjo përvojë e veçantë. Auditori i përgjithshëm u mirëprit në takim edhe nga auditorja e përgjithshme e japonisë dr. Mari Kobayashi, e cila ka shprehur kënaqësinë për rezultatet e mira dhe rritjen e kapaciteteve në Zyrën Kombëtare të Kosovës duke nënvizuar vullnetin e saj për t'i përkrahur institucionet e Kosovës në rrugëtimin për menaxhim efektiv të pasurisë publike. Gjatë vizitës në Japoni, delegacioni nga Zyra Kombëtare e Auditimit ka vizituar edhe Ambasadën e Kosovës në Japoni.

Ministri Shala në Samitin e Ballkanit Perëndimor fton investitorët e huaj të investojnë në Kosovë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, po merr pjesë në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Poznan të Polonisë. Ai nga Polonia bëri thirrje për investime të huaja në Kosovë dhe ka prezantuar avantazhet që ka Kosova në të bërit biznes

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, është duke marrë pjesë në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Poznan të Polonisë, duke e përfaqësuar Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ministri Shala në fjalën e tij në këtë samit ka deklaruar se Republika e Kosovës është duke bërë çdo ditë ndryshime në infrastrukturën ligjore që t'iu krijohen kushte sa më të mirë investitorëve të huaj. "Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është duke punuar çdo ditë në infrastrukturën ligjore për thithjen e investimeve të huaja direkte, për efektet e para pas fillimit të implementimit të Ligjit për Investime Strategjike", ka thënë Shala. Po ashtu, ai ka treguar për mundësitë që i ofron Kosova

për investitorët e huaj, duke treguar se Kosova ka punuar shumë për ndërtimin e infrastrukturës moderne, duke mundësuar lidhjen me vendet e Ballkanit. "Kosova tashmë ka autostradat më moderne që mundësojnë lidhjen e Republikës së Kosovës me vendet e Ballkanit për kohë rekorde. Po ashtu, kemi një rini jashtëzakonisht inovative, që e do punën", ka thënë Shala. Ministri ka bërë me dije se janë duke punuar në reforma dhe në përmirësimin e ambientit të bërit biznes. Ai ka kërkuar që marrëveshjet rajonale të shikohen si një rrugë dykahëshe dhe të respektohen nga të gjitha palët e përfshira. Ky samit po mbahet në kuadër të procesit të Berlinit, me qëllim të përfortimit të bashkëpunimit rajonal dhe avancimin e procesit të integritimit evropian.



Sot nënshkruhet marrëveshja e granteve për sektorin e pemëve të imta

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), bashkë me USAID-in, sot (e premte) do të organizojnë ceremoninë zyrtare të nënshkrimit të granteve investive me disa

përfitues për sektorin e pemëve të imta. Ceremonia e nënshkrimit fillon në orën 10:00 dhe mbahet në fshatin Sekiraqë të Komunës së Podujevës, në kompaninë "Liberion", e cila është një ndër

përfitueset e granteve. Në këtë organizim do të marrë pjesë sekretari i përgjithshëm i MBPZHR-së, Kapllan Halimi, drejtori i Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, Brian Martalus, përfituesit e këtyre

granteve si dhe pjesëmarrës të tjerë", thuhet në njoftimin e MBPZHR. Ministria e Bujqësisë më 22 maj ka hapur periudhën për aplikim për disa nga masat mbështetëse për këtë vit përmes granteve



investive për fermerët në gjithë territorin e Kosovës.

Shpallet fituesi i konkursit për tregun e Ulpianës

PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Tregu i Ulpianës në Prishtinë së shpejti do të marrë formë krejtësisht tjetër pasi që Komuna e Prishtinës ka shpallur fituesin e konkursit për ndërtimin e tregut në këtë lagje të kryeqytetit.

Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kanë shpallur fituesin e konkursit, ndërsa tani do të fillojnë punën për zbatimin e projektit dhe zbatimin e tij.

"Është shpallur fituesi i konkursit për tregun e Ulpianës. Urime fituesit! Tani fillojmë punën për projektin zbatues dhe zbatimin e tij", ka njoftuar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook".



Nis ndërtimi i konviktit dhe mensës në Universitetin e Mitrovicës 'Isa Boletini'



MITROVICË, 4 KORRIK (ER) - Kanë nisur punimet për ndërtimin e konviktit dhe mensës së studentëve në kompleksin e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" (UMIB). Këto dy projekte tepër të rëndësishme për universitetin në vlerë prej 6 milionë eurosh do të financohen nga Ministria e Administratës Publike (MAP).

Rektori i UMIB-it, Alush Musaj, i shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm, Xhelal Smakiqi, kanë vizituar punishten ku kanë filluar të ndërtohen këto objekte, të cilat do të krijojnë kushte jashtëzakonisht të mira për studentë. Ai shprehu kënaqësinë me fillimin e punimeve për ndërtimin e konviktit dhe mensës të cilat do ta

kompletojnë kompleksin të ri universitar.

Rektori tha se me këto investime kompleksi universitar në Mitrovicë do të jetë ndër më të mirët në rajon. "Pas ndërtimit të objekteve për fakultete dhe Rektoratit, tash ka filluar të ndërtohet konvikti dhe mensa dhe së shpejti edhe fushat e sportit, me çka merr formën përfundimtare kompleksi i ri universitar në Mitrovicë".

Konvikti planifikohet të ketë 270 shtretër, ndërsa të dy objektet do të përfshijnë një hapësirë prej 2 000 metrash katrorë. Sipas dinamikës së paraparë, pritet që punët të kryhen për dy vjet. Punimet janë duke u kryer nga Acg - Ada - Consulting Group SHPK.

Delegacioni i ekspertëve kundër terrorizmit i BE-së viziton Policinë e Kosovës



PRISHTINË, 4 KORRIK (ER) - Në Policinë e Kosovës ka qëndruar një delegacion ekspertësh kundër terrorizmit i BE-së, i cili u prit të enjten nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së

Kosovës, Rashit Qalaj, me bashkëpunëtorë.

Temë e diskutimit me ekspertët e BE-së ishte identifikimi i nevojave si dhe të përpunohen bashkërisht veprimet prioritare

të bëra për Kosovën në luftën kundër terrorizmit, parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe kushtet për zbatimin e tyre dhe mundësitë për mbështetjen nga BE-ja për

veprimet prioritare.

Ekspertët nga BE-ja shprehën vlerësimin e lartë për përkushtimin dhe përkrahjen e Kosovës në hartimin e planit të përbashkët të veprimet kundër

terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, ku angazhimi dhe bashkëpunimi i Kosovës në këtë fushë të rëndësishme u mirëprit edhe nga shtetet anëtare të BE-së.

Nga 43 fshatra të Malishevës, 40 bëhen me kryetarë të rinj

MALISHEVË, 4 KORRIK (ER) - Procesi zgjedhor për kryetarë të fshatrave dhe zonën urbane të qytetit të Malishevës është duke vazhduar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë nga

komisioni komunal.

Në kuadër të këtij procesi janë zgjedhur edhe tre kryetarë të fshatrave, në Banjë, Muhamet Begaj; në Carrallukë, Rustem Hoti; në Kërvasari, Albert Bytyçi,

kurse në zonën urbane të qytetit të Malishevës kryetar është zgjedhur Lulzim Mazreku. Në këtë kontekst Malisheva është duke hyrë në përmbyllje të zgjedhjeve për kryetar të fsha-

trave, ku nga 43 fshatra që ka kjo komunë, 40 prej tyre janë bërë me kryetarë të rinj. Në këtë proces zgjedhor pritet shumë shpejt të zgjedhën edhe kryetarët në fshatrat e mbetura.




Putini viziton Romën dhe Vatikanin

MOSKË, 4 KORRIK - Presidenti rus, Vladimir Putin, gjendet për vizitë në Romë ku do të zhvillojë bisedime me udhëheqësit italianë dhe gjithashtu është planifikuar të takohet me Papa Françeskun në Vatikan. Disa analistë, kanë thënë se vizita e Putinit, mund të vendosë bazat për një vizitë potenciale të Papës në Rusi. Agjencia ruse e lajmeve TASS, njoftoi se vizita e 4 korrikut, do të përfshijë bisedime me presidentin italian, Sergio Mattarella dhe kryeministrin Giuseppe Conte.

Udhëheqësi rus kërkon t'i forcojë lidhjet ekonomike me Italinë e cila është anëtare e NATO-s dhe BE-së. Zëvendëskryeministri italian, Matteo Salvini, i cili ka shprehur admirim për Putinin, ka bërë thirrje për lehtësimin e sanksioneve të BE-së të vendosura kundër Moskës, për shkak të aneksimit të Krimesë, dhe për mbështetjen e saj ndaj luftëtarëve separatistë në Ukrainën Lindore. Putini tha në një intervistë me gazetën italiane Il Corriere della Sera se vlerëson

"angazhimin e Italisë për të forcuar mirëkuptimin reciprok në zonën euroatlantike". "Ne kemi një marrëdhënie të veçantë me Italinë, që është testuar me kohë", tha ai. Rusia dhe Perëndimi janë në tensione të vazhdueshme lidhur me çështjet që përfshijnë konfliktet e Ukrainës dhe Sirisë, ndërhyrjen e Moskës në zgjedhjet e vendeve të tjera, dhe sulmin nervor ndaj ish-agentit të dyfishtë rus, Sergei Skripal dhe vajzës së tij në qytetin jugor britanik, Salisbury.



Festime të mëdha për 4 Korrikun, demokratët akuza për politizim

Presidenti amerikan Trump premtoi se do të jenë festimet më të mëdha të organizuara ndonjëherë për 4 Korrikun, ku do të ketë edhe parakalim tankesh, por kjo i ka shtyrë kritikët të thonë se presidenti po i jep frymë ushtarake një feste kombëtare jopartiake

WASHINGTON, 4 KORRIK - Festimet për ditëlindjen e 243-të të Shteteve të Bashkuara duken ndryshe këtë vit, ndërsa presidenti Trump i dha atyre frymën ushtarake krahas ceremonisë tradicionale në Kapitol, ku ndodhet godina e Kongresit amerikan. Presidenti Trump po akuzohet për shndërrimin e festimeve normalisht jopolitike të 4 korrikut, në një aktivitet me tone politike.

Pamjet dhe tingujt e festimeve në Kapitol janë të mirënjohura për pothuajse çdo amerikan. Por këtë vit, në cepin tjetër të shëtitorës kombëtare, po bëhen përgatitjet për një tjetër aktivitet, atë të presidentit Donald Trump, të quajtur "Nderim për Amerikën", ka njoftuar voa.

"Kjo është mënyra amerikane, apo jo?! Duam të bëjmë diçka madhështore, diçka spektakolare", thotë Phil Grucci, i firmës së fishkëzjarrëve "Grucci".

Firma "Grucci" është një ndër dy kompanitë që kanë dhuruar fishekzjarrë për këtë aktivitet, një kontribut që presidenti e përmendi në Twitter. Ai ka

premtuar se do të jenë festimet më të mëdha të organizuara ndonjëherë, ku do të ketë edhe parakalim tankesh. Kjo i ka shtyrë kritikët të thonë se presidenti po i jep frymë ushtarake një feste kombëtare jopartiake. "Ajo çfarë do të shohim do të jetë një ditë ekstravagance politike e partiake, e paguar nga taksapaguesit amerikanë, në epiqendër të së cilës do të jetë Donald Trumpi. Kjo është hera e parë që një president amerikan e orienton 4 Korrikun për qëllimet e veta", thotë përfaqësuesja demokrate e Distriktit të Kolumbias, Eleanor Holmes Norton.

Ligjvënësja Norton thotë se qyteti pret që qeveria federale të paguajë koston për dëmet që do t'u shkaktohen rrugëve nga tanket ushtarake dhe makineritë e tjera të rënda të sjella në qytet për aktivitetin e presidentit, i cili ka urdhëruar sjelljen e bombarduesve, tankeve dhe pajisjeve të rënda luftarake. Megjithatë, disa thonë se nuk i shqetëson kjo gjë.

"Jam krenar dhe mirënjohës për ushtarakët që i shërbejnë vendit



tonë dhe vlerësoj vërtet sakrificën e tyre dhe të familjeve të tyre. I jam gjithashtu mirënjohës presidentit që po e vlerëson dhe kremton këtë gjë", thotë Brent Hoban, i cili po viziton Uashingtonin.

Sidoqoftë disa prej anëtarëve demokratë të Kongresit u shqetësuan prej njoftimeve se shpenzimet do të përballoheshin nga fondet e Departamentit

Kombëtar të Parqeve, ndërsa ata mendojnë se ky do të jetë një aktivitet politik për presidentin. Ndërsa, bëri një përmbledhje të fjalimit që do të mbajë presidenti, këshilltarja e Shtëpisë së Bardhë, Kellyanne Conway u kërkoi gazetarëve që pyetjet për koston t'ia drejtojnë Departamentit të Mbrojtjes.

"Është për demokracinë tonë të mrekullueshme. Është edhe një

thirrje e madhe për patriotizëm. Ka të bëjë me hapjen e kaq shumë vendeve të reja të punës nga kjo administratë, dhe për gjithçka kemi bërë për veteranët", tha Conway. Tradicionalisht, festimet për 4 korrikun nuk i mëshojnë aspektit ushtarak dhe kritikët po e akuzojnë presidentin se po e shfrytëzon Ushtrinë amerikane për të fituar përkrahje politike.

Tensionohen raportet mes Iranit dhe Britanisë së Madhe

TEHERAN, 4 KORRIK - Irani ka thirrur ambasadorin britanik për t'u ankuar, në atë që Teherani thotë se është konfiskim ilegal i një cisterne iraniane të naftës. Marinsat britanikë ndihmuan autoritetet në Gjibraltari, të kapnin anije transportuese, për shkak të provave, se ajo po shkonte në Siri, duke shkelur kështu sanksionet e BE-së. Ministri i Jashtëm spanjoll, Josep

Borell, tha se konfiskimi i anijes - Grace 1 - u bë me kërkesën e ShBA-së.

Një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme iraniane tha se mbajtja e cisternës së saj ishte e paligjshme.

Të dhënat nga "Renifitiv Eikon", një burim i të dhënave për lëvizjen e cisternave, tregon se anija ishte ngarkuar nga Irani.

Nëse konfirmohet se cisterna

është ngarkuar nga Irani, në përpjekje për ta dërguar në Sirinë e shkatërruar nga lufta, atëherë kjo përbën shkelje të sanksioneve të ShBA-së për eksportuesit iraniane të naftës.

Irani, së bashku me Rusinë, i kanë dhënë mbështetje të rëndësishme presidentit sirian Bashar al-Asad, gjatë gjithë luftës civile të Siri, që tani ka hyrë në vitin e nëntë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Martohen dy qentë e dashuruar

Dy qen kanë kurorëzuar në martesë dashurinë e tyre. Lola dhe Bear u martuan në qershor. "Fox News" ka raportuar se pronari i qenve, Andrea Crawford, porositi një kostum për Bear dhe për Lolën një fustan dasme. Media e huaj ka publikuar edhe foton e qenve të veshur si nuse e dhëndër.



BARSOLETA E DITËS



Njëri që deshi të bëhej polic ndoqi një kurs të cilin e drejtonin të huajt. Kur kishin testin përfundimtar atij i shtrohet pyetja: Nëse e sheh një hajdut duke e vjedhur një dyqan, çfarë do të bëni? Kandidati: Do ta thërras policinë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
"THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min
Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
Regjia: Chris Renaud and Jonathan Del Val



FOTO E DITES



Garda Ceremoniale e FSK-së në përvjetorin e pavarësisë së ShBA-së, së bashku me Shoqatën 'Miqte e Amerikës', ka bërë ngritjen e flamurit amerikan në Prishtinë, në sheshin që mban emrin e ish-presidentit amerikan Bill Clinton.

Ne ora 18:00

"X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

Rolet: James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
Regjia: Simon Kinberg



Në ora 20:00

"MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

Rolet: Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
Regjia: F. Gary Gray



Ne ora 22:00

"M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown
Regjia: Tate Taylor



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

E rrallë

Piramida 4 000-vjeçare kthehet në atraksion turistik

Një piramidë e zbuluar në shek e 19 në Egjipt do të kthehet në një atraksion turistik. E ndërtuar 4 000 vjet më parë, në të është zbuluar një dhomë varrimi ku besohet se prehet faraoni Sensusret II, i Mbretërisë së Mesme. Piramida pritet të jetë atraksioni më i ri turistik i Kajros.



<p>DASHI Sot jeni të shpërqendruar dhe nuk po arrini të mbyllni asgjë. Jeni zhytur në botën tuaj të emocioneve dhe çdo gjë ju duket pa lidhje me situatën tuaj.</p>	<p>DEMI Zakonisht nuk tërhiqeni shumë nga personat dhe i shihni në detaje. Por sot do të bini pre e një dashurie me shikim të parë që do të turbullojë çdo gjë.</p>	<p>BINJAKËT Autoironia juaj dhe optimizmi që përçoni sot do të vijëzohet buzëqeshje edhe në ata persona që konsiderohen cinikë dhe të ftohtë.</p>	<p>GAFORRJA Ambienti që ju rrethon do të ketë mjaft pasion dhe ritme të shpejta për çdo situatë. Do të ndiheni të përfshirë në një vorbull të këndshme.</p>	<p>LUANI Jeni mjaft të sigurt në atë që bëni sot dhe keni energjinë e nevojshme për të arritur në finalizimin e detyrave që ju jepen.</p>	<p>VI RGJËR ESHA Të mund të besoni te dikush është shumë mirë dhe në një marrëdhënie sentimentale besimi është gjëja më e rëndësishme për ju.</p>
<p>PESHORJA Nëse do të jeni nën tension sot nuk mund të mbyllni dot asgjë. Merrni kohën tuaj dhe qetësoni nervat për të dalë në vendime që janë frytdhënëse.</p>	<p>AKREPI Kapni momentin sot dhe shfrytëzoni çdo mundësi. Jeni mjaft karizmatik dhe do të jetë e vështirë për të tjerët të mund t'ju rezistojnë.</p>	<p>SHIGJETARI Edhe pse jeni tipa impulsivë sot në marrëdhënien në çift impulsiviteti juaj mund të shkatërrojë gjithçka.</p>	<p>BRICJAPI Rrallë njerëzit mund të perceptojnë që ju jeni tip i ndjeshëm, por sot do të zhvisheni nga koraca juaj dhe do t'i shprehni emocionet.</p>	<p>UJORI Do të jeni mjaft konfliktuale sot me këdo që gjeni përpara. Me ose pa arsye ndiheni si të zënë në kurth dhe doni të reagoni.</p>	<p>PESHQIT Sot jeni të aftë të dëgjoni ata që kanë probleme rreth jush dhe t'u jepni zgjidhjen e duhur. Çdo gjë shkon mirë me financat dhe me dashurinë.</p>

Lady Gaga dhe Bradley Cooper presin një fëmijë



Qëkur Lady Gaga dhe Bradley Cooper u shfaqën së bashku në "A star is Born", u fol për një lidhje romantike mes tyre. Pati sigurisht mohime, por pak kohë më parë u dha lajmi i ndarjes së aktorit nga bukuroshja Irina Shajak. Ndërkohë që tetorin e shkuar edhe


Lady Gaga ishte ndarë nga i fejuari i saj, Kristian Karino. Tani tabloidët amerikanë shkruajnë se Lady Gaga dhe Bradley Cooper presin një fëmijë. "Të gjithë thonë se Lady Gaga është shtatzënë dhe se po fsheh një bark të rrumbullakosur", thotë një burim për revistën amerikane "In Touch".

Alexa dhe Carlos bëhen sërish prindër



Alexa dhe Carlos PenaVega janë bërë sërish prindër. Ata mirëprehen në jetë fëmijën e dytë Kingston James. Aktorët zbuluan lajmin përmes rrjeteve sociale duke postuar një fotografi

të familjes nga spitali në Maui, Hawaii. "Është zyrtare. Jemi katër tani", ka shkruar Alexa. Alexa dhe Carlos njoftuan shtatzëninë në fillim të këtij viti para se ta zbulonin gjininë dhe emrin e foshnjës.



Brad Pitt bëhet edhe më tërheqës në moshën 55-vjeçare

Brad Pitt tregoi pamjen e tij të mirë në ballinën e magazinës australiane për burra 'GQ Australia', për të cilën foli edhe për jetën e tij personale dhe karrierën. Pitt e vërtetoi

se është bërë më tërheqës në moshën 55-vjeçare kur ai pozoi për këtë magazinë. Ai tregoi edhe dallimin se si është të aktrosh si një djalë i ri dhe si është si një burrë i moshuar.

Reperi i njohur arrestohet në Suedi

ASAP Rocky u arrestua në Suedi nën dyshimin për sulme të rënda. "TMZ" ka raportuar se reperi 30-vjeçar dhe ekipi i tij u ndeshën fundjavën e kaluar. Zënka dyshohet se filloi me një njeri që po e ndiqte artistin. Ai tani mund të përballet me gjashtë vjet burgim në Suedi nëse dënohet.



ÇFARË (NUK) MUNDET GAZETARI?

Gazetarët janë pjesëtarë të fuqisë së shtatë. Jo, edhe më mirë, ata janë pushteti i katërt. A thua vërtet? A janë gazetarët aq të fuqishëm sa flitet? A janë të identifikueshëm në rrugë saqë e marrin mishin e freskët, nën tezgë, tek kasapi apo edhe peshkun e freskët në peshkatore? Ekzistojnë edhe mendime të tjera, sipas të cilave, gazetarët janë njerëz të vlerave më të ulëta, të pabesueshëm, që nuk meritojnë respekt, që janë të korruptueshëm, manipulues, të pae-dukuar dhe dembelë, aq sa askund tjetër nuk do të mund të punonin.

Cila është e vërteta? Apo këto janë disa lloje të paragjytimeve që qarkullojnë përreth gazetarëve dhe mediave?

E vërteta është diçka tjetër. Gazetaria është profesion, por edhe zeje. Gazetarët duhet t'i pjekin mjeshtritë e zejës pa të cilat nuk mund ta ushtrorin profesionin e tyre. Por, nuk janë profesionistë sikurse janë mjekët, arkitektët dhe të tjerët; sepse "çdonjëri raporton për personat e tjerë, mbi ngjarjet dhe idetë, por gazetarët profesionistë duhet të jenë më të vëmendshëm sesa amatorët në mënyrë që mos ta shtrembërojnë të vërtetën, e thonë në sqarimin e tyre William Rivers dhe Alison Work.

Gazetarja e njohur amerikane dhe profesoresha e gazetarisë, Sherry Ricchiardi, në këtë mënyrë ua sqaron studentëve profesionin e gazetarit: "Mund ta pyesni këdo për atë që dëshironi, t'i vizitoni cilado ngjarje, ta fusni hundën në punët e të tjerëve, të kërkonti biseda nga më të rëndësishmit dhe më të ndikueshmit, kreyt kjo, vetëm për atë se jeni gazetarë. Për aq më shumë juve ju paguajnë që ta kënaqni kureshtjen".

Tingëllon të jetë joshës, apo jo?

Të drejtat e mëdha të gazetarëve

Po, gazetarët kanë të drejta të mëdha. Disa janë të fituara, por shumica e tyre bazohen te zgjedhjet ligjore, ndërsa një prej të drejtave më të mëdha është që të dinë. E drejta për t'u qasur informacionit është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe bazike për ushtrimin e papengueshëm të profesionit të gazetarit.

Në shumicën e vendeve, që nga viti 2006 edhe në Kroaci, ekziston ligji mbi të drejtën e qasjes në informacion si për gazetarët, po ashtu edhe për secilin qytetar. Pandeher se secili informacion është publik, ndaj dhe nuk bën të mbetet në fshehtësi, përveçse nëse është i rregulluar me ligj si sekret shtetëror apo ushtarak. Por, asnjë pushtet nuk është i lumtur nëse detyrohet që publikisht t'i tregojë disa veprime të vetat, ndaj dhe bën përpjekje që në të gjitha mënyrat e mundshme t'i dekurajojë qytetarët, në veçanti gazetarët, që të arrijnë tek informacioni i duhur.

Jelena Berković, një gazetare e re në Radio 101 nga Zagrebi, i ka

kërkuar disa të dhëna nga Zyra për Informim e Qeverisë, por nuk ka arritur t'i marrë. E pakënaqur ka ushtruar padi ndaj kryetarit të Qeverisë së Kroacisë të bazuar pikërisht në Ligjin në fuqi për qasje në informata. Gjyqi ka qenë i gjatë, por pas një viti e drejta ka triumfuar. Jelena e ka fituar kontestin dhe i ka fituar një krah me dokumente të cilat i ka kërkuar. Dokumentet kanë qenë të vjetruara tashmë, më nuk kanë shërbyer për tregimin për të cilin i janë nevojitur, por e ka fituar një satisfaksion. Por jo vetëm kaq: gazetarët e kanë kuptuar se kanë të drejtë ligjore si dhe mundësi që të kërkojnë informacione, ndërsa administrata e ka kuptuar se kjo është diçka serioze, për aq më tepër kur edhe kryeministri e humbet një kontest gjyqësor.

Parimet e punës së gazetarit

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve (IFJ) është organizatë kulmore dhe e strukturuar që u themelua në vitin 1926 dhe e cila i ka rreth 500 000 anëtarë të mbledhur në 162 shoqata të 116 vendeve. Një prej veprimtarive më të rëndësishme është siguria: rreth 1 000 gazetarë janë vrarë në dhjetë vjetët e fundit, ndërsa globalizimi dhe përqendrimi i pronësisë e rrezikon pluralizmin e medias.

IFJ i ka vendosur parimet bazë të profesionit të gazetarit dhe angazhohet për të drejtat themelore të gazetarëve ndaj dhe i ka sjellë parimet në bazë të të cilave gazetarët e gjithë botës duhet të sillen. Parimi më themelor i profesionit të gazetarisë është pavarësia nga cilado qoftë ideologji. Nuk ka gazetar të mirëfilltë nëse ajo zë fill në ndonjë ideologji. Ajo ideologji mund të jetë më e mira në botë, por gazetaria duhet të mbështetet në parimet e tjera. Parimi i dytë i rëndësishëm është pavarësia materiale e gazetarëve. Gazetari nuk mund të jetë i pavarur nëse punon në kushtet të cilat ia pamundësojnë jetën normale.

Parimet e punës në gazetari, sipas Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, janë:

- o Pavarësia redaktuese dhe raportuese,
- o Liria e të menduarit dhe e të shprehurit,
- o Respektimi i standardeve profesionale dhe etike,
- o Ligjshmëria: kushtet e drejta dhe të barabarta në punë.
- Standardi i të vepruarit profesional në të mbledhurit, bartjen, të interpretuarit dhe të komentuarit e lajmeve dhe të ngjarjeve është përcaktuar me Deklaratën e IFJ-së, e cila është aprovuar në vitin 1954 në Kongresin Botëror, ndërsa është plotësuar në vitin 1986.
- Sipas Deklaratës, detyrat e gazetarit janë:
- o Respektimi i së vërtetës dhe e drejta e opinionit mbi të vërtetën,
- o Mbrojtja e parimeve të lirisë në kolektimin e ndershëm dhe pub-



STJEPAN MALOVIQ

Stjepan Malović (Stjepan Malovic) është doktor i shkencave të informimit, drejtimi i Komunikologjisë dhe profesor inordinar në Universitetin e Dubrovnikut. Është drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Edukim të Gazetarëve (ICEJ). Gazetar shumëvjeçar i cili iu përkushtua analizës shkencore të medias dhe të edukimit të gazetarëve. Deri më tash ka qenë autor, bashkautor dhe redaktor i pesëmbëdhjetë librave me temën median, ndërsa ka botuar dhjetëra punime shkencore dhe profesionale për mediat. Ka marrë pjesë në 30 tubime vendore dhe 50 ndërkombëtare, në konferenca, seminare dhe tryeza shkencore.

Është koordinator i projektit "Tempus", i cili, në bashkëpunim me Universitetin e Vjenës si dhe Shkollën e Lartë të Gazetarisë në Lil, e zhvillojnë programin për aftësimin e medias. Është një prej themeluesve të SEEMO (South East European Media Organisation), të cilën e ka iniciuar International Press Institute (IPI) në Vjenë. Ka qenë prodekan në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Zagrebit si dhe udhëheqës i Akademisë së Gazetarëve EuropaPress Holdinga. Në gazetari është që nga viti 1967, kur u regjistrua në shkollën e Vjesnikut (Vjesnik) të Zagrebit. Në Veçernji list (Večernji list) ka vepruar që nga viti 1968 deri në vitin 1991, ku ka qenë gazetar, korrespondent, së fundmi redaktor. Në periudhën nga viti 1985 deri në vitin 1990 ishte zëvendëskryeredaktor.

likimin e lajmeve, o Raportimi vetëm në pajtim me faktet për të cilat dihen burimet si dhe mosheshja apo falsifikimi i dokumenteve, o Shfrytëzimi i vetëm metodave të ndershme për mbledhjen e lajmeve dhe sajimin e tyre, të fotografive si dhe të dokumenteve, o Përmirësimi i çfarëdo informate e cila është e dëmshme për shkak të pasaktësisë, o Respektimi i fshehtësisë profesionale dhe moszbulimi i burimeve, o Të vetëdijshëm për rrezikun nga të diskriminuarit dhe shmangja e tij me çdo kusht, veçanërisht të atij që bazohet në diferencat racore, gjinore, gjuhësore, fetare, politike, kombëtare apo edhe atyre shoqërore.

Gabimet themelore profesionale

Gazetarët gabojnë si të gjithë të tjerët. Nuk ka të pagabueshëm. Por, gabimet gazetareske janë publike. Të gjithë i shohin, nuk mund të fshihen dhe, shumë shpesh, mund të jenë mjaft të pakëndshme si dhe mund t'u shkaktojnë dëme të pamatshme individëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Për këtë arsye në gazetari, kujdesshëm, analizohet veprimtaria ditore, ndërsa evoluohet çdo gjë që është botuar me qëllim që të evidentohen gabimet dhe të përmirësohen ato.

Gabimet më të mëdha profesion-

ale janë:

- o PLAGJIATURA: Marrja e paautorizuar dhe e qëllimshme e punës së tjetrit,
- o SHPIFJA: akuzat ofenduese, të pasakta dhe të pabazuara,
- o PRANIMI I RYSHFETIT: në çdo rast dhe në çdo kuptim.
- Për këtë, profesioni i gazetarisë bën gjithçka është e mundshme që të ruhet dinjteti i gazetarëve.
- IFJ-ja thekson se gazetarët e denjë për atë thirrje besnikërisht do t'u përmbahen parimeve të shprehura në kuadër të ligjeve të përgjithshme në shtetet e tyre. Gazetarët, në kuptimin profesional, do ta pranojnë vetëm gjykimin e kolegëve gazetarë, në mënyrë që ta shmangin ndërhyrjen e qeverive apo edhe të qendrave të tjera të forcës. Kjo është shumë e rëndësishme ngaqë vetërregullimi i profesionit është e vetmja mënyrë e mundshme me të cilin do të mund të mënjanohej negativitetet si dhe mosrespektimi i parimeve profesionale dhe etike.

Edhe pushteti i ka ca të drejta

Të drejtat gazetareske mund t'i ngushtojë pushteti. Sa më shumë demokratik të jetë shteti, ndërsa shoqëria e hapur, aq më pak kufizohen të drejtat dhe e drejta e të menduarit, të folurit dhe e të shprehurit. Por në vendet demokratike ekziston një lloj rregullimi ligjor, dhe kështu, secili shtet e bën rregullimin e radiotele-

vizionit publik, ndarja e koncesioneve dhe e frekuencave gjithashtu rregullohet, ndërsa disa shtete e bëjnë edhe rregullimin e televizioneve kablore.

Shtetet autoritare e kufizojnë atë që është e paparamendueshme në demokraci, ashtu që mëtohet edhe kufizimi i internetit. Frika e sistemeve autoritare nga të shkruarit kritik shpërfaqet edhe nëpërmjet kufizimeve ligjore. Sistemet totalitare e kontrollojnë shpërndarjen e shtypit, por edhe shtypshkronjat. Me këtë kontrollohet edhe përmbajtja, ndaj dhe nuk botohen ato përmbajtje që janë të padëshirueshme për pushtetin.

Shteti i ka disa të drejta që të kufizojë disa përmbajtje në medie. Kështu, të thuash në të gjitha vendet ndalohet reklamimi i hapur i cigareve dhe alkoolit. Arsyja, mbi të gjitha, është e natyrës shëndetësore. Dëmi i konsumimit të cigareve dhe alkoolit është i atillë që shoqëria mbrohet përmes ndalesës së reklamimit i cili e çyt konsumimin e cigareve dhe të pijeve alkoolike. Por, të hyrat nga tatimi mbi cigaret dhe alkoolin janë të rëndësishme për arkën e çdo shteti, ndaj dhe, jo rrallë, mbyllen sytë ndaj formave të fshehura të reklamimit. Tek ne është e njohur seria e reklamave të Fabrikës së Duhanit në Rovinj, e cila, përmes "Të fala nga Rovinji", i përkujton cigaret dhe jo qytetin e Rovinjit. Ky stil i të reklamuarit është bërë shumë i suksesshëm, ashtu që shpërfaqen edhe pinguinët simpatikë të cilët na argëtojnë. Pinguinët nuk e pinë duhanin, por na përhëndesin nga Rovinji, ashtu që mesazhi i ndërmjetësuar është se si pirja e duhanit është e mirë.

Është e turpshme pjesëmarrja e gazetarëve në veprimtaritë propaganduese. Ndaj dhe, të gjitha shoqat e gazetarëve repretësisht ua ndalojnë gazetarëve që, në çfarëdo mënyrë, të marrin pjesë në reklamim, por kjo qëndron vetëm në letër ngase në medie mbisundon zëdhënia e mbuluar. Gazetarët janë të kërkuar si autorë reklamash, dhe këtë e bëjnë për arsye financiare. Por, ekziston edhe një tendencë akoma më e keqe, me ç'rast redaksitë i detyrojnë gazetarët që të shkruajnë reklama të mbuluara për disa njerëz dhe ndërmarje ngase kjo është pjesë e kontratës së reklamimit. Kështu gazetarët e humbasin kredibilitetin dhe e rrënojnë autoritetin e tyre.

Shteti e mbikëqyrë edhe një formë të medias, e këto janë përmbajtjet pornografike. Porno industria është e fuqishme, vepron në medie por, megjithëkëtë, është e vëmendshme ndaj disa rregullave. Mediet janë të vërsuara me femra lakuriqe, me fotografi joshëse, kryesisht të bukurshëve, shumë rrallë edhe të meshkujve, por nuk ka edhe xhirime eksplicite pornografike. Megjithëkëtë, një pjesë e mediave të shtypura janë në kufi të pornografisë. Për këtë shteti e udhëheq politikën vijuese: erotika dhe lakuriqësia kalojnë,

ndërsa hard porno është i kufizuar nëpër dyqanet e specializuara.

A duhet të mbrohemi nga gazetarët

A janë gazetarët të aftë që seriozisht t'i dëmtojnë njerëzit dhe a mundën që pushtetin e tyre të madh në publikim ta keqpërdorin dhe me këtë të shkaktojnë dëme të (pa)përmirësueshme? Zharko Puhovski në "Të enjten mediatike në 19", në pranverë të vitit 2017, e ka thënë se tashmë ka ardhur koha që të mbrohemi nga gazetarët që kanë fuqi dhe mundësi të shkaktojnë dëme të mëdha individëve dhe pa asnjë lloj përgjegjësie për këtë gjë.

Vërtet, kushdo që mbi lekurën e vet e ka përjetuar se çfarë do të thotë sulmi mbi të, mund të pajtohet me Puhovskin. Nuk ekziston asgjë më e keqe sesa kur merren me ty, për aq më tepër nëse ti as nuk e ke ngrënë hudhrën që të vijë era hudhër. Përmirësimi, përgjigjja, polemika: të gjitha këto janë post festum, dhe secila prej këtyre kuptohet si shpëlarje e mëkatit, arsyetim, ndërsa dëmi, tashmë, është shkaktuar dhe mund të bëhet përpjekja vetëm të zvogëlohet apo edhe të shpresohet se sulmi, ashtu, në heshtje do të kalojë në harresë.

Më së shpeshti gazetarët as që janë të vetëdijshëm për fuqinë e tyre dhe të kapaciteteve shkatërruese të sulmeve të tyre në medie. Disa, madje, mendojnë se detyrë e tyre e shenjtë është që dikë ta "apostrofojnë", "ta gozhdohin në murin e turpit", "ta shpartallojnë", "ta shkatërrojnë si..." Në një pjesë të qarqeve gazetareske numërohen viktimat, rirrefehen fjalët, fotografitë dhe toni me të cilin është sulmuar dikush. Të thuash në secilin prodhim medial ekziston rubrika, emisioni apo edhe ndonjë krijimtari e ngjashme që merret me shpërfaqjen publike të "petkave të pista", të thashethemnajave, të shpifjeve që vijnë nga burime vështirë të besueshme, por që janë gjithmonë pikante, interesante, shumë të lexuara, të dëgjua dhe të shikuara.

Puhovski këtë e temë e ka zgjeruar edhe te sjellja e gazetarëve të cilët i kanë privatizuar mediat, e që kanë fuqi që dikujt t'i thonë se vetëm mund të ëndërrojë se kur do të gjenden më në gazetën e "tij", në emision apo rubrikë. Shi për këtë është shumë me vend pyetja se a na nevojitet mbrojtja nga gazetarët dhe shkrimet e tilla?

Disi, në po këtë kohë, Mila Jelaviq, avokate e popullit, ligjëronte në temën "Të drejtat e fëmijëve në publik" në studimin e saj "Mediat dhe kultura e shoqërisë" në Universitetin e Dubrovnikut. Aty një student e pyeti se: a ekziston mënyra që të dënohet gazetari i cili me raportimin e tij të keq dhe joetik i ka shkaktuar dëme fëmijës për të cilin shkruan? Nuk ekziston, ishte përgjigjur hidhur ombuspersonja. Por do të duhej të kishte, komentuan studentët.

Dhe, a ka ardhur koha që të mbrohemi nga gazetarët? Derisa kjo temë është pëshpjelluar, ndërmjet shënimeve të mia është publikuar lajmi se është sulmuar Zheleko

Malnar. Gjoja se, një shikues, pakënaqësinë e vet me emisionin e Malnarit e ka shfaqur përmes goditjes së gazetarit me një shufër të metaltë, në kokë. Malnar as që doli nga spitali, ndërsa do ta "zëvendësojë" Arsen Oremoviqi, redaktori i "Veçernji listit", për shkak të përmendjes së kryeministrit Sanader në kontekst të papërshtatshëm. Redaksia, pa prituri reagime publike, e sanksionoi redaktorin e vet. Gazetarët është e qartë se nuk përgjigjen për (keq)bërjet e tyre. Qoftë përmes zëvendësimit, qoftë përmes argumentit (të shufrës) në kokë.

A është kjo e mjaftueshme apo nevojiten edhe sanksione të tjera për gazetarët e papërgjegjshëm? Dhe, çfarë na qenka gazetaria e papërgjegjshme? A ka të drejtë personi të cilin e ka ofenduar gazetari apo edhe sulmuar të përgjigjet në të njëjtën mënyrë apo është ndërrimi - mos e thënë Zoti shufra - sanksioni adekuat?

Është e padyshimtë se ka ardhur koha që të rishqyrtohen përgjegjësitë e gazetarëve, por edhe me shqyrtime serioze a mundën që qendrat e fuqishme, të pakënaqura me gazetarinë, ta marrin drejtësinë në duart e veta? Debati është i domosdoshëm, ndërsa është fat i madh që është botuar vepra kapitale "Deontologjia e medias", e ekspertit francez të medias, Claude-Jean Bertranda, profesorit emeritus në Sorbonë, që është promovuar edhe në Zagreb.

Gazetarët gjithmonë i shqyrtojnë parimet bazike të etikës në profesionin e tyre duke u përpjekur që t'i zbatojnë në praktikë. Bertrand këtë e quan: zhvillim i vetëdijes mbi standardet profesionale të gazetarisë së përgjegjshme me çfarë mund të shmangen shembujt e gazetarisë së keqe. E kjo, njëherësh, është mbrojtja më e mirë nga sulmet mbi gazetarët.

Edhe një rast e ka trazuar skenën mediale. Gjykimi i Domagoj Margetiqit për shkak të publikimit të dëshmitarëve të mbrojtur dhe mosrespektimit të Gjykatës së Hagës për krime të luftës i cili ka përfunduar pa shumë reagime dhe, të thuash, në qetësi si dhe dënimi prej tre muajve burg dhe 10 000 eurove duke mos shkaktuar jehonë mediatike siç mund të jetë prituri sidomos pas reagimeve të zëshme të Margetiqit para gjykim-it.

Kam prituri ta shoh se a do të reagojë ndokush për këtë por, përveç Danko Plevnikut, të gjithë e kanë heshtur këtë rast. A thua, në saje të medieve kroate, Margetiqi do të mbahet mend si gazetari i parë, të cilin, e ka dënua Gjykata për Krime të Luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë?

Secili gazetar do të duhej të neveritej nga fakti se Margetiqi përfshihet në këtë profesion serioz, të përgjegjshëm dhe të domethënshëm. Cilësimi i Margetiqit si gazetar menjëherë e hapë pyetjen se: kush janë gazetarët? Dhe, si bëhesh gazetar?

Në disa prej profesioneve kjo është e qartë dhe e pakontestueshme: mjek bëhet ai i cili ka diplomuar në Fakultetin e Mjekësisë, arkitekt ai

që ka diplomuar në Fakultetin e Arkitekturës. Në spital nuk mund të punojë dikush që ka vetëm dhunti për shërim, siç as për projektin e një ndërtese nuk mund ta fitojë lejen e ndërtimit dikush që nuk është i autorizuar.

A janë gazetarët të gjithë ata që kanë diplomuar në gazetari? S'do mend se nuk janë. A janë të gjithë gazetarët qytetarë me shkollim të lartë? S'do mend se nuk janë. Disa prej gazetarëve nuk kanë diploma dhe mezi e kanë të mbaruar shkollën e mesme. A janë të gjithë gazetarët anëtarë të Shoqatës së Gazetarëve? S'do mend se nuk janë. A janë gazetarët personat që kanë ndonjë leje të veçantë për publikimin e punës gazetareske? Po sigurisht se nuk janë!

Kush janë atëherë gazetarët? Dhe përse, atëherë, Margetiqi nuk është gazetar? Pyetja, siç e shikojmë, është shumë më e ndërlikuar sesa vetë rasti Margetiq.

Liria është themeli bazë i gazetarisë. E drejta e secilit njeri për lirinë e të shprehurit të mendimeve bazohet tek të drejtat e njeriut e që është edhe parimi kryesor mbi të cilin mbështetet veprimi i masmedias. Baza elementare e të drejtës së njeriut për të menduar dhe shprehur nuk mund të cenohet duke e përcaktuar atë se kush mund të jetë gazetar. Çdonjëri e ka të drejtën që të vijë në redaksi dhe ta ofrojë një tekst. Vetë vlera e atij teksti e përcakton atë se a do të botohet apo jo. Pra, nuk ekzistojnë kurrfarë kufizimesh mbi atë se kush mund të bëhet gazetar. Vetëm në Itali ekzistojnë licenca për gazetar dhe kundër saj ankohet Shoqata Ndërkombëtare e Gazetarëve.

Po përse, atëherë, Margetiqi nuk mund të jetë gazetar? Për atë se nuk i ka respektuar parimet themelore të profesionit të gazetarit: raportimin e vërtetë, të saktë, të balancuar dhe të paanshëm. Margetiqi e ka lirinë e plotë në shpërfaqjen e qëndrimeve dhe të komentimit të ngjarjeve, por gazetari gjatë raportimit duhet t'i respektojë rregullat e profesionit dhe mos t'i përziejë faktet me qëndrimet personale.

Sot çdokush mund ta iniciojë uebfaqen e vet apo blogun, por kjo nuk duhet të nënkuptojë se është edhe gazetar. Sot pa kurrfarë kufizimi mund të iniciohet një gazetë, por kjo nuk e nënkupton se aty kemi të bëjmë me gazetari të vërtetë.

Gazetarët janë pjesëtarë të një profesioni serioz i cili i është ekspozuar gjykimit të opinionit dhe të cilët, nëse nuk respektohen standardet dhe etika profesionale e gazetarisë, përballen me kritika dhe konsekuenca. Detyra e medias në shoqëritë demokratike është shumë serioze që me të të merren individë të paedukuar dhe të padijshëm, të dëgjueshmit, spinunë të imtë apo edhe manipulues. Gjykimi i publikut e vlerëson se a është ndonjë produkt mediatik gazetaresk apo është fryt i sensacionalizmit apo edhe i ndonjë organizate gjysmësekrete. Disa tabloide thashethemnajash apo edhe emisione televizive gjysmë-pornografike mund të jenë të lexuar apo edhe të shikuara, por ajo nuk

është gazetar.

Vetërregullimi i profesionit të gazetarit është mënyra më e mirë e përcaktimit se çfarë është gazetari dhe se kush mund të shpallet gazetar. Gazetarët të cilët Margetiqin e quajten gazetar e treguan se sa pak dinë për profesionin e tyre duke mos e respektuar etikën e gazetarisë. Dhe, nuk është Margetiqi i rëndësishëm, por shtrohet pyetja se a janë gazetarë ata që mendojnë se ai është gazetar.

(Mos)cilësia e medias është një temë e pashmangshme dhe jo vetëm në qarqet e ngushta gazetareske, por edhe në opinion. Ante Gavranoviç, një prej doajenëve të gazetarisë kroate, shkruan tek gazeta Novinar, se çështja e cilësisë së medias është e rëndësishme për atë se "mediet, mbi të gjitha ato elektronike, gjithnjë e më shumë po shfrytëzohen për krijimin e opinionit publik, pavarësisht nga pasojat. Forcimi i ndikimit të gazetarisë së varur nga kuotat e (jo)kycjes së shikuesve dhe të dëgjuesve, si trend për përfitimin e publikut dhe (jo rrallë) për pasione të ulëta".

Kush është përgjegjës për këtë? Gazetarët, pronarët, qendrat e veçanta të fuqisë apo skuadra e zëdhënësve, financierëve dhe magnatëve mediatikë?

Më e lehta është që të akuzohen gazetarët, të cilët, një pjesë e opinionit i përjeton si njerëz të pashkolluar dhe të padijshëm. A është kjo kështu?

Derisa po e shkruaj këtë tekst në një nga klasat e shtëpisë së gazetarëve një grup prej rreth njëzet gazetarësh kroate të gjeneratës së mesme, në mënyrë intensive punon me profesorin Bauer nga Universiteti i Vjenës. Në rrjedhë janë ligjëratat përfundimtare të projektit të madh të Tempusit Journalism Education and Training in Croatia (JETiC). Bëhet fjalë për edukimin e instruktorëve të rinj të gazetarisë, të cilët provimin përfundimtar do ta kenë në Vjenë në fund të muajit. Në të njëjtën kohë, gjenerata e parë e studentëve të Universitetit të Dubrovnikut do t'u nënshtrohet provimeve të fundit në studimet paradiplomike "Mediat dhe kultura e shoqërisë". Këta janë studentët e parë në Kroaci të cilët po e përfundojnë fazën e parë të shkollimit sipas parimeve të Deklaratës së Bolonjës. Në vjeshtë do të duhej t'i vazhdojnë studimet diplomike. Dhe, përderisa fushatat zgjedhore po marrin hov, madje katër grupe me nga 15 studentë do ta ndjekin seminarin nga raportimi zgjedhor të cilin e organizon Qendra Ndërkombëtare për Edukim të Gazetarëve në bashkëpunim me OSBE-në, njëzet gazetarë të rinj, të tanishëm dhe të ardhshëm janë duke dëgjuar ligjëratat e shkollës "Studime Intermediale".

Gjykuar sipas kësaj, gazetarët shkollohen dhe përgatiten në mënyrë të denjë dhe e përhapin dijen e tyre. Ndërsa ne jemi të pakënaqur me nivelin e shkollimit të tyre dhe i shpallim si të padijshëm dhe me përçmim e tundim dorën kur debatohet mbi cilësinë e medias.

Fakti është se gazetari, radioja, tele-

vizioni dhe interneti vijnë nga gabimet, budallallëqet, mosdija e gjërave elementare, mosnjohja e profesionit, e sidomos gramatikës dhe drejtshkrimit, e për çfarë na përkujton edhe Nives Opaçiq në hulumtimet e tij.

Kështu, a thua kemi arritur, përsëri, tek një nga paradokset e medias? Nga njëra anë prodhimet e dobëta të medias, ndërkohë që profesioni është duke u edukuar, po përsoset dhe po shkon në hap me dijet e reja?

Trend i gazetarëve të paedukuar mjaftueshëm po vazhdon. Nga njëmbëdhjetë anëtarët e ri të pranuar në Shoqatën e Gazetarëve Kroatë, tetë prej tyre e kanë përgatitjen e mesme profesionale, ndërsa vetëm tre të lartën. Edhe më keq është situata tek anëtarët korrespondentë. Nga njëzet e një syresh, gjashtë janë me shkollim të lartë, të tjerët, katërmëdhjetë, me shkollë të mesme.

Me këtë, pronarët, më shumë se qartazi e tregojnë se çfarë gazetarë dëshirojnë të kenë: të rinj dhe të pashkolluar mjaftueshëm. Të tillët janë nëpër redaksi, një lloj argjile e cila ngjeshet mirë sipas dëshirave dhe kërkesave të të fuqishmëve të medias. Gazetarët e rinj dhe jomjaftueshëm të edukuar nuk i njohin mjaftueshëm standardet, nuk dinë ta bëjnë dallimin mes asaj se çfarë është etike e çfarë është lëndim i privatësisë së individit, pastaj lehtë mund të binden që ta "shkatërrojnë" dikë, që të publikojnë pa menduar tekste nga një burim i vetëm, që mos t'i verifikojnë informacionet, që të mos ankohen kur redaktori ua shton ndonjë fjalë, t'i i rrudhin krahët nëse dikush kërkon të bëhet ndonjë përmirësim në artikull për shkak të të dhënave të pasakta.

Gazetarët me përvojë nuk janë një brumë i mirë për manipulim. Ata e dinë se çfarë është mirë profesionalisht e çfarë nuk është por, gjithashtu, kanë prirje që ta ulin kokën dhe ta lidhin kalin aty ku u thuhet. Branko Tugjen në mënyrë jashtëzakonisht e të sinqertë e ka thënë në TV: "E çfarë kam mundur të bëjë? Isha 40 vjeç!" duke aluduar në atë se sa e vështirë është që ta humbasësh punën në moshën e mesme, të mbetesh pa të ardhura e, ndoshta, t'ia nisësh nga fillimi në ndonjë profesion tjetër, e kjo vetëm për shkak të dofarë parimeve.

Pikërisht këtu fle përgjigjja në pyetjen mbi nivelin e ulët të mediave kroate si dhe për dijen dhe profesionalizmin e pamjaftueshëm. A u nevojiten të fuqishmëve të medias gazetarë kualitativë apo të dëgjueshëm? Apo, ç'nevojitet cilësia kur kërkohet sensacionalizmi, skandali, përcipshmëria, manipulimi...?

Përgjigjja nuk është vetëm te profesioni, as vetëm te pronarët, por është e një domethënie esenciale që ka të bëjë me rolin e shoqërisë civile si dhe zëri më i fuqishëm i opinionit që do të ngrihet në mbrojtje të të pavarurës, të përgjegjshmes dhe të gazetarisë kualitative.

(Përktheu nga kroatishtja: Shpresë Mulliqi. Marrë nga numri i pestë i revistës "Akademia")

Xhamia-“UFO”, në Katar thyejnë traditën me arkitekturën moderne



Kjo xhami e cila gjendet në Katar, nga jashtë ka pamje të një anije ajrore që sapo ka zbritur në tokë. Minaretë e saj janë të ngritura në drejtim të Mekës. Oborri në qendër të xhamisë

është i dekoruar me kaligrafi dhe modele gjeometrike. Xhamia ka pesë shtylla që përfaqësojnë pesë shtyllat e Islamit rreth të cilëve rrjedhin katër lumenj. Të katër lumenjtë për-


faqësojnë lumenjtë e Xhenetit – të verës, qumështit, mjaltit dhe ujit. Në brendi të saj ka hapësirë namazi për burra, ndërsa në galerinë më lart për gra. Xhamia

ka një kapacitet prej 1,800 njerëz. Ajetet Kur'anore janë në qendër të tavanit të cilat çojnë në Mihrab – një tipar që është gjetur në planet tradicionale të xhamive.

I veçantë është edhe ndriçimi që emetohet nga hapjet trekëndësh të madhësive të ndryshme, dhe kjo për besimtarët është një ndjenë sikur janë duke u falur nën yje!



Njihuni me vendin që ofron 24 473 euro pagë për ruajtjen e deleve




Ishulli skocez Ronaldsay, ka publikuar një shpallje të pazakontë për vende të lira pune. Kërkohen barinj që do të paguhen mirë që të kujdesen për një lloj të rrallë të deleve –

Orkney. Ky ishull është në kërkim të barinjve me përvojë që do të kujdeseshin për delet që të hanë vetëm ushqimin e planifikuar nga pronarët, të qarkullojnë në

lokacione të sigurta dhe të qëndrojnë sa më larg kafshëve tjera. Barinjtë gjithashtu do të duhet të sigurohen që delet të qëndrojnë sa më larg murit që ndan tokën ku mbillen perimet e

ndryshme nga të cilat edhe jetojnë banorët e ishullit. E pasi që ky mur është shumë i vjetër, ata do të duhet ta rinovojnë. Bëhet fjalë për 35 orë në javë, ku paga do të jetë 24,473. E të

gjithë ata që e pranojnë punën, do të detyrohen ta respektojnë kontratën trevjeçare me qëllimin e vetëm që muri të rinovohet plotësisht, kurse numri i deleve të rritet.

	Autor: GAZMEND MORINA		MJET KOMUNIKIMI (shq.)	METAFORË E GJATË	SUPER MODELJA BRAZILIANE ADRIANA	PARA TË NËNTËS	KËNGA E POPULLARIZUAR QYTET NË SHQIPËRI	<h2 style="text-align: center;">SUDOKU</h2> <table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <tr><td>1</td><td></td><td></td><td>6</td><td></td><td>9</td><td></td><td>4</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>8</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>1</td></tr> <tr><td></td><td>9</td><td>2</td><td>7</td><td></td><td>5</td><td></td><td>3</td><td></td></tr> <tr><td></td><td></td><td>4</td><td></td><td>2</td><td>6</td><td></td><td></td><td>5</td></tr> <tr><td>6</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>9</td></tr> <tr><td></td><td></td><td>7</td><td>8</td><td></td><td></td><td></td><td>4</td><td></td></tr> <tr><td></td><td>4</td><td></td><td>3</td><td></td><td>1</td><td>5</td><td>8</td><td></td></tr> <tr><td>5</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td>9</td></tr> <tr><td></td><td>7</td><td></td><td>5</td><td></td><td>4</td><td></td><td></td><td>3</td></tr> </table>	1			6		9		4			8							1		9	2	7		5		3				4		2	6			5	6								9			7	8				4			4		3		1	5	8		5								9		7		5		4			3
	1			6		9			4																																																																																
		8								1																																																																															
		9	2	7		5			3																																																																																
			4		2	6				5																																																																															
	6									9																																																																															
			7	8					4																																																																																
		4		3		1	5		8																																																																																
5								9																																																																																	
	7		5		4			3																																																																																	
FILOZOF NË GREQINË E LASHTË (shq.)																																																																																									
PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)																																																																																									
FRIKË E MADHE																																																																																									
							LLOJ DRURI																																																																																		
PËRFAQËSI DIPLOMATIKE MË E ULËT SE AMBASADA (hist.) FONI ALBA					AKTORJA ... FRIEL LLOJI I NJE PRODHIMI SIPAS FORMËS E MADHËSISË																																																																																				
KËNGËTARJA RITA ...						DITMAR HAMAN SIPËR	AKTORJA JOSIPI OHAJO, LUZIANA NGJYRË E FYTYRËS PJESË E ILIRISË KARBON, INTENSITET																																																																																		
INICIATIVA							QYMEZ ELEMENT KIMIK (SE)																																																																																		
EPOKA E RE	ISH KËNGËTARI AMERIKAN NË FOTO	TUPAN	SHTET NË EVROPE	SCREEN ACTORS GUILD	ZANORE	ZANORE KËNGËTARJA ... ISTREFI	OSMAN BAJRAMI KUDRET ISAI	LLOJ PIJE E NXEHTË E ORIENTALE (shq.) SHITRËSË																																																																																	
PUBLICISTI SHQIPTAR YPI	<input type="radio"/>						DISIPLINË SPORTIVE KA A DEM I PATREDHUR (shq.)	NAIM ISMAJLI SHASTISEM	KRYEQYTETI I JORDANISË																																																																																
NJOLLA	<input type="radio"/>				PEZMATIM I VESHIT REGJISORI ... SOPI			ISH FUTBOLLISTI SHEARER (orgj.) LUMË NË AFRIKË	RESHAT ARBANA SHOSHITET																																																																																
E NDRYRË, BANALE AKTROJA & MODELJA JOVOVICH	<input type="radio"/>						KUJDES I VEÇANTË QË TREGOJMË PËR DIKË ISMET PEJA																																																																																		
	<input type="radio"/>			PJESËMARRJA NË NJË GARË DHËMBOR				MINDERI I ULËT (shq.) I ÇMENDURI	ZANORE SHKENCA QË MERRT ME KRIJIMIN E MALEVE																																																																																
DIÇKA LËNDORE KONKRETE E BOTËS JO TË GJALLË; GJË (shq.)	<input type="radio"/>					THIRRJA QË I BËHET MASËS AI ME TË CILIN QUHEMI		ELEMENT KIMIK (NT) "RIADI"																																																																																	
BASHKËT.	<input type="radio"/>	GJOJA, KINSE GODINA MBI LUMË					BASHKËT. NDALIMI	GRYKA E VULLKANIT NËNË (turq.)																																																																																	
MBRON DIÇKA NGA DIKUSH	<input type="radio"/>				FUTBOLLISTI SULLEY (MILAN) SHKEL E SHKO, RRËMUJË			FUTBOLLISTI SAMUEL ... LLOJ PAPANAGALLI	VETI E ATLJ QË ËSHTË TRIM																																																																																
ISMET RAMUSHI	<input type="radio"/>		TANTAL, REOMIR BIMË QË PËRDORET PËR TË MBULUAR ÇATITË (shq.)			LETRARI MEHMETI (shq.) KËNGËTARJA NJOMZA		AZEM MAKSUTAJ LUMË NË KOSOVË	DY BASHKËTINGËLLORE PAJTUESHMËRI (krah.)																																																																																
LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL	<input type="radio"/>						KUNDËRSHTAR I BOLSHEVIZMIT RUS ZANORE		"E" në mes të dy "R" GROSETO, ATALANTA																																																																																
BASHKËT.	<input type="radio"/>	ALUMIN, AMPËR ARRATISUR				KËNGËTARJA ... FARA ELIZABETH BANKS		STUHIA E FORTË ME ERË DHE SHI ZANORE																																																																																	
"LL" pas dy "I"	<input type="radio"/>			USHQIM QË SHTROHET E HAHET GJATË PIJES NATRIUM, TON			"EPOKA ... KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK		SHKRIMTARI SHKRELI ISH AKTORJA AMERIKANE GARDNER																																																																																
EPOKA E RE	LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.) DY BASHKËTINGËLLORE							KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË ... RAMA ARTIOLA TOSKA	LEJE PËR TË SHKUAR NGA ODA EDITA SOPJANI																																																																																
BIXHOZ					KËNGËTARJA VALENTINA BASHKËT.			VEJAN ZANORE	ANA RUSO ISLANDA																																																																																
EMËR YNI DJALI (shq.)						BANORI I ATIKËS			ZANORE																																																																																

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: TALESI, ELITAT, LEMERI, LEGATA, FO, ANA, ORA, DM, NISMA, KOTEC, I, OB, SALEPI, EDISON, KRICKET, NI, LARA, OTIT, ALAN, RA, VULGARË, INTERESIM, MILLA, GARIMI, NIMI, A, SENDI, APELLI, NITON, P, DEMEK, N, KRATERI, RUANA, MUNTARI, ETO, IR, TAR, DINI, AM, GJT, SAKARINA, ESER, RER, LL, ALA, ELI, URAQANI, ILLI, MEZE, ERE, AZEM, KANABISI, INA, IZE, KUMAR, RAMA, I VE, AR, DRITANI, ATIKASI, I. ZGJIDHJA E SUDOKUT: KOJONA I: 135 689 699 742; KII: 786 432 951; KIII: 492 715 638; KIV: 314 926 875; KV: 658 147 329; KVI: 927 853 416; KVII: 249 361 587; KVIII: 563 278 194; KIX: 871 594 263.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ejupi: Sot vendoset e ardhmja e Mirel Josës

Remzi Ejupi për "Epokën e re" ka zbuluar se sot (e premte) do të ketë një takim me trajnerin Mirel Josa, ku edhe do të vendoset përfundimisht e ardhmja e trajnerit shqiptar. "Jam jashtë Kosovës, por do të rikthehem dhe të premtën kam një takim me trajnerin. Në atë takim do të vendosim për të ardhmen, por një gjë mund të konfirmojë se Josa është shumë i mërzhitur pas eliminimit dhe ka shfaqur dëshirën për t'u larguar", ka thënë Ejupi



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 KORRIK - FC Prishtina është eliminuar nga garat e Ligës së Evropës pas humbjes në ndeshjen kthyesë nga Joseph's (2-0). Fatura e eliminimit i është atribuar trajnerit nga Shqipëria, Mirel Josa, nga tifozët "Plisat" dhe analistët e futbollit në Kosovë. Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" e ka kontaktuar të enjten presidentin e klubit kryeqytetas, Remzi Ejupin, i cili bëri me dije se e ardhmja e trajnerit shqiptar do të vendoset sot (e premte). "Jam jashtë Kosovës, por do të rikthehem dhe të premtën kam një takim me trajnerin. Në atë takim do të vendosim për të ardhmen, por një gjë mund të konfirmojë se Josa është shumë i mërzhitur pas eliminimit dhe ka shfaqur dëshirën për t'u larguar", ka thënë Ejupi, i cili më pas ka vlerësuar lart

punën e trajnerit Josa gjatë kokës që është pjesë e Prishtinës, ani pse në dy sezonet që e drejtoi këtë skuadër nuk arriti ta fitojë titullin e kampionit, derisa sukcesi i tij ishte triumfi në garën e Kupës në edicionin e kaluar. "Ne duhet të kemi parasysh dhe jemi falënderues ndaj trajnerit për punën e madhe që ka bërë në skuadrën tonë", ka shtuar Ejupi.

Trajneri Mirel Josa edhe përkundër përvojës së madhe në vazhdimësi është kritikuar për rezultatet që ka regjistruar me skuadrën "bardhekatër", por edhe me mënyrën e lojës që Prishtina e ka aplikuar nën drejtimin e tij. Mirëpo kjo nuk i ka penguar dhe ai vazhdimisht e ka pasur mbështetjen nga drejtuesit e klubit, por eliminimi nga një skuadër siç është Joseph's po del të jetë një problem i madh për strategun shqiptar, i cili gjatë karrierës së tij ka drejtuar: Tiranën, Lushnjën,

Skënderbeun, Vllazninë, Elbasanin, Teutën dhe Shkumbinin.

Kryetari i "Plisa"-ve, Albert Kastrati, ka hedhur dyshime se dy ndeshjet ndaj St Joseph's kanë qenë të kurdisura nga Klubi i Prishtinës, mirëpo Remzi Ejupi ka thënë se është e turpshme të mendohet një gjë e tillë për faktin se Prishtina ka dhënë maksimumin për ta kaluar këtë kundërshtar. Ejupi e përmendi edhe rrugëtimin e gjashtë 20 orësh deri në Gjibraltari, por edhe shumën e të hollave që do të kishte fituar në rast kualifikimi në fazën tjetër. Në anën tjetër, edhe përkundër faktit se ende nuk është vendosur përfundimisht e ardhmja e Mirel Josës, kanë filluar të qarkullojnë zëra në lidhje me trajnerin e ri. Fillimisht është përmendur Afrim Tovërlani, kurse më pas edhe ish-përzgjedhësi i Kosovës, Albert Bunjaki dhe Gani Sejdiu e Bylbyl Sokoli.

SHKURT

Liburni mëson kundërshtarët në Ligën e Kampionëve

Kampioni i Kosovës në Futsall, Liburni i Gjakovës, ka mësuar kundërshtarët e mundshëm në Ligën e Kampionëve. Skuadra gjakovare do të jetë pjesë e fazës së dytë kualifikuese pas koeficientit mjaftueshëm të lartë falë sukseseve të klubeve të Kosovës në katër vjetët e fundit në këtë garë. Liburni do të jetë pjesë e grupit 7, së bashku me skuadrën nga Bjellorusia, Stalitsa Minsk. Dy kundërshtarët e tjerë do të mësohen pas përfundimit të fazës parakualifikuese.

Ylli vazhdon marrëveshjen me Krasniqin

KB Golden Eagle Ylli ka arritur marrëveshje për vazhdimin e kontratës me trajnerin Arben Krasniqi. Ky i fundit e ka drejtuar skuadrën nga Suhareka edhe në edicionin e fundit. "Bashkë me trajnerin Krasniqi po përgatitet lista e lojtarëve vendor dhe të huaj për sezonin që na pret", thuhet në njoftimin e Yllit.

Buffoni rikthehet te Juve

Pas një viti larg Torinos, Gianluigi Buffon, është rikthyer në shtëpi teksa ka nënshkruar një kontratë njëvjeçare me Juventusin. Legjenda italiane kaloi 17 vjet te bardhezinjtë duke u aktivizuar 656 ndeshje në të gjitha garat, duke fituar shumë trofe. Pas përfundimit të kontratës njëvjeçare, 41-vjeçari pritet të emërohet në një post drejtues te "Zonja e Vjetër".

Llapi prezanton Umitin dhe Thaqin

Skuadra e Llapit po vazhdon përforsimet për edicionin e ri futbollistik 2019/2020. Kjo skuadër e ka prezantuar të enjten transferimin më të ri i cili është Emir Umiti. 19-vjeçari vjen nga Belgjika, përkatësisht klubi i tij i fundit është SC Chatelet, kurse ka luajtur edhe për Namur. Umit është futbollist i talentuar dhe pjesë e Përfaqësueses së Kosovës U19, derisa ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën e Llapit. Mesfushori Erijon Thaqi është futbollisti i dytë që të enjten u prezantua nga skuadra e Llapit. Thaqi së fundmi ishte pjesë e KF Onix, kurse ka nënshkruar kontratë trivjeçare me skuadrën që drejtohet nga Tahir Batatina.

Prishtina mëson kundërshtarin në Ligën e Kampionëve

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kampionia e Kosovës në Basketball, Z Mobile Prishtina, ka mësuar kundërshtarin në kualifikimet e Ligës së Kampionëve. Prishtina do të ndeshet me skuadrën polake Legia Varshava. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 17 shtator në Prishtinë, kurse ajo e kthimit më 20 shtator në Poloni. Nëse

skuadra e Prishtinës e kalon Legian e Varshavës, atëherë do të ballafaqohet me skuadrën ruse Nizhny Novgorod. Ndeshjet ndaj skuadrës ruse do të zhvillohen më 26 dhe 29 shtator. Nëse Prishtina e kalon edhe këtë kundërshtar do të luajë në grupe. "Bardhekaltrit" do të jenë në Grupin C. Në Grupin C do të luajnë Riga, Peristeri,

Gaziantep, Tenerife, Cez Nymburk, Bamberg dhe fituesi Benfica/Groningen/Mornar. Pra, Benfica do të ndeshet me Groningenin e më pas fituesi me Mornarin dhe fituesi kualifikohet në Grupin C. Në grupe do të jenë 32 skuadra, që janë ndarë në katër grupe me nga tetë ekipe, ku katër të parat kalojnë tutje.



Ferrari nuk i ndryshon pilotët as në 2020-n

ROMË, 4 KORRIK - Pas garës së Austrisë u përhapën zëra se Max Verstappen mund të largohet nga Red Bulli për të pilotuar një Ferrari sezonin e ardhshëm. Gjithsesi, shefi i "kokëkuqes", Mattia Binotto, ka deklaruar se dy pilotët e Ferrarit për vitin 2020 do të jenë sërish Sebastian Vettel

dhe Charles Leclerc. "Ne kemi një kontratë në fuqi me dy pilotët aktualë dhe jemi të kënaqur me ta. Ndaj, sezonin e ardhshëm dyshja Vettel-Leclerc është e rikonfirmuar. Nuk kemi asnjë arsye për t'i ndryshuar pilotët tanë", u shpreh Binotto. Kjo deklaratë mbyll edhe

shanset e një rikthimi të spanjollit Fernando Alonso te Ferrari. Kohët e fundit është përfolur se dy herë kampioni i botës mund të rikthehet në Formula 1 me "kokëkuqen". Gjithsesi, duket se të gjitha këto fjalë do të mbesin në kuadrin e thashethemeve.



Gashi: Përrurimi i stadiumit në Han të Elezit, kënaqësi e veçantë

"Ky investim është në kuadër të investimeve për avancimin dhe fuqizimin e infrastrukturës sportive dhe është interesimi ynë që ta masivizojmë sportin në të gjithë Republikën e Kosovës", ka deklaruar Gashi

PRISHTINË, 4 KORRIK - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë sot përrurimin e Stadiumit në Komunën e Hanit të Elezit. Me këtë rast ministri bëri të ditur se vlera e tërësishme e stadiumit është rreth 220 mijë euro. Ky investim është bërë në bashkëpunim mes MKRS-së, Federatës së Futbollit të Kosovës dhe komunës. "Është kënaqësi e veçantë që të jem në përrurimin e një prej investimeve më të rëndësishme në këtë komunë. Jam shumë i lumtur që bashkë me komunën dhe Federatën e përfunduar në një afat rekord këtë projekt kapital duke pasur parasysh se ndërtimi i këtij stadiumi ka qenë kërkesë për vite tëra, por ne pas marrëveshjes me kryetarin e përfunduar për disa muaj", ka thënë ministri Gashi.

"Ky investim është në kuadër të investimeve për avancimin dhe fuqizimin e infrastrukturës sportive dhe është interesimi ynë që ta masivizojmë sportin në të



gjithë Republikën e Kosovës", ka deklaruar Gashi, i cili ka falënderuar kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës dhe atë të Komunës së Hanit të Elezit për bashkëpunim në finalizim të këtij projekti dhe ka theksuar se projekti i nisur për ndërtimin e 12 fushave është shumëfishuar.

Nga ana tjetër, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, dhe ai i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, falënderuan ministrin për kontributin e jashtëzakonshëm në futboll dhe shprehen besimin se nga ky terren me kushte kaq të mira do të dalin futbollistë shumë të mirë.

Vashat e Kosovës sot përballen me ato të Sllovenisë

PRISHTINË, 4 KORRIK - Kosova U-18 në konkurrencën e femrave, pas përgatitjeve në Prishtinë, sot (e premte) do të garojë në Kampionatin Evropian, Divizioni B. Takimi i parë është ndaj Sllovenisë nga ora 14:15. Ky Evropian do të zhvillohet në Maqedoninë Veriore (5-14 korrik). Vashat e Kosovës ndodhen në një grup shumë të vështirë, duke marrë parasysh se janë më të reja në moshë se kundër-



shtaret e tyre, megjithatë, priten paraqitje të mira dhe synim është një fitore në grup. Kosova është në Grupin A, së bashku me Slloveninë, Estoninë, Danimarkën, Norvegjinë dhe Finlandën. Në këtë Evropian marrin pjesë 24 kombëtare, që janë të ndara në katër grupe me

gjashtë shtete. Tri kombëtalet e para do të kualifikohen në Divizionin A. Dy përfaqësueset e para në grupe do të kualifikohen në çerekfinale, vendi i tretë dhe i katërt do të luajnë për pozitën 9-16, kurse vendi i pestë dhe i gjashtë në grupe do të luftojnë për pozitën 17-23.

SHKURT

Lampardi, trajner i Chelseat

Chelsea ka zyrtarizuar menaxherin e ri. Klubi londinez ka angazhuar ish-mesfushorin Frank Lampard si menaxher të ri në kontratë trevjeçare. Lampard është larguar nga Derby County në Championship për ta marrë drejtimin e skuadrës ku kishte kaluar 13 vjet si futbollist. Në këtë pozitë, Lampard zëvendëson Maurizio Sarrin i cili është larguar nga Chelsea, duke marrë drejtimin e Juventusit. Ish-reprezentuesi anglez ka bërë 648 paraqitje me Chelsean, duke fituar 11 tituj me ekipin londinez.

Dermaku nga Cosenzan kalon te Parma

Mjaftuan dy sezone të mira me Cosenzan në Serinë C dhe më pas në B për të bërë hapin cilësor. Kastriot Dermaku tashmë është lojtar i Parmës, që ka afruar në skuadër qendërmbrojtësin e përfaqësueses shqiptare me parametër zero. 27-vjeçari bëri një paraqitje shumë të mirë edicionin e kaluar me Cosenzan, duke u aktivizuar në 33 takime, 32 prej të cilave i nisi si titullar dhe duke shënuar një gol, atë të fitores minimale ndaj Spezias. Një paraqitje e tillë nuk ka lënë pa tërhequr vëmendjen e klubeve italiane, por kalimi te Parma është një surprizë e vërtetë edhe për vetë futbollistin, që sheh një mundësi të artë jo vetëm për t'i treguar aftësitë e tij në elitën e futbollit italian por, mbi të gjitha, në një skuadër të njohur. Gjithashtu, Dermaku fitoi simpatinë e trajnerit të ri të kombëtares shqiptare, Edy Reja, i cili e vendosi si titullar në sfidën ndaj Islandës, kjo ndikuar edhe nga mungesa e Mërgim Mavrajt.

City prezanton Rodrin

Kampionia e Premierë Ligës, Manchester City, e ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit spanjoll Rodri nga Atletico Madridi. Blerja e Rodrit i ka kushtuar skuadrës angleze 62.6 milionë funte ose 70 milionë euro, aq sa ishte klauzola e lojtarit dhe është bërë transferimi më i shtrenjtë në histori të klubit anglez. "Manchester City është i kënaqur ta njoftojë nënshkrimin e mesfushorit spanjoll Rodri. 23-vjeçari bashkoi me një marrëveshje pesëvjeçare nga Atletico Madridi dhe ndjek Angelinon duke u bërë nënshkrimi i dytë i verës për Pep Guardiolan", thuhet në njoftimin e Cityt.

Reali dhe Juventus vazhdojnë garën për Pogban

Nga Anglia sa vijon dhe shtohen zërat se Paul Pogba do të largohet nga Manchester Unitedi. Sipas raportimeve të fundit, francezi dëshiron që të transferohet te Real Madridi. Reali deri tani ka blerë 4 lojtarë: Hazard, Mendy, Joviq dhe Militao dhe i duhet t'i largojë disa lojtarë nga ekipi për shkak të numrit të madh të lojtarëve. Problemi tjetër është edhe "fair-play" financiar. Vlera e katër blerjeve të Realit i kalon 300 milionë euro dhe blerja e Pogbas mund t'i nxirrte probleme Realit me rregullat e UEFA-s. Nga Italia Juventus kërkon që Pogba të kthehet në Serinë A. Juventus ka një projekt shumë ambicioz dhe e shikon 26-vjeçarin si pjesë të këtij projekti. Te Reali apo Juventus mbetet për t'u parë, por largimi i Pogbas nga Manchester Unitedi është e sigurt parashikojnë mediet angleze.

Pensionohet Robbeni

Ish-ylli i Bayern Munchenit, Real Madridit dhe Chelseat, Arjen Robben i ka dhënë fund karrierës së tij. "Jam menduar shumë gjatë javëve të fundit. Siç e dinë të gjithë, mora kohën time për të marrë një vendim për të ardhmen time pas ndeshjes së fundit me Bayern Munich. Dhe kam vendosur t'i jap fund karrierës sime si futbollist profesionist. Është padyshim vendimi më i vështirë që kam marrë në karrierën time. Një vendim ku mendja dhe zemra janë përplasur me njëra-tjetrën. Për momentin jam i shëndetshëm dhe si një tifoz i shumë sporteve të tjerë dhe dua të mbetet kështu për të ardhmen. Kështu që do të ndalem përfundimisht. Mendoj se kjo është gjëja më e mirë", ka thënë Robbeni.

GRUPI A

Të premten takohen:
14:15 Kosova-Slovenia

Të shtunën takohen:
21:00 Estonia-Kosova

Të dielën takohen:
16:30 Kosova-Danimarka

Të martën takohen:
18:45 Norvegjia-Kosova

Të mërkurën takohen:
14:15 Kosova-Finlanda



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.30/2019-06/1datë14.06.2019

Në bazë të nenit 13 pika 1 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Rekomandimit nga Komisioni përgjegjës të shkresës nr.1530/3 datë 03.07.2019 Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M
Për përsëritje të Konkursit publik,

- I. Konkursi publik nr 1530, datë 14.06.2019, për **Mjekë Specialistë Infektolog QKUK-së** për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të kandidatëve vazhdohet edhe për 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit.
- II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni përgjegjës sipas Vendimit nr. 1530/2 datë 19.06.2019, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit pa se nuk ka nr të mjaftueshëm të kandidatëve dhe rekomandoi që të vazhdohet konkursi edhe për 15 ditë sipas nenit 6 pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë, ku kërkohet që konkurrenca të jetë më e madhe.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe rekomandimit në fjalë, lejon përsëritjen e Konkursit publik për **Mjekë Specialistë Infektolog** të QKUK-së, edhe 15 ditë.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Pellumbi 137, Lakinshë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 531; 600 552
www.kmdk-ks.org

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

Bordi i Drejtorëve të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Republikën e Kosovës (KMDK SH.A), në mbledhjen e mbajtur me datë 28/06/2019, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 26.6 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë Rregullore Nr. 01/2017 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës në KMDK SH.A ka vendosur të:

Shpall Konkurs Publik për pozitën:

1. **Pozita: Sekretar/e e Ndërmarrjes Publike KMDK SH.A (1 pozitë)**
Vendi i punës: KMDK SH.A, zyrat qendrore Prishtinë
Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të parapara me Ligjin për NP-të dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike.
 - Mirëmban regjistrin e aksionarëve.
 - Vepron si agjent i Kompanisë për pranimin e njoftimeve.
 - Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetin përkatës siç mund të kërkohet me ligj ose me statut.
 - Koordinon me Bordin e Drejtorëve, përgatitjen e letrave (dokumenteve) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
 - Mban procesverbalet e secilës mbledhje dhe mbledhjes së Përgjithshme të Bordit të Drejtorëve dhe Komiteteve të Bordit dhe kujdeset që ato të jenë protokoluara.
 - Kryen dhe detyra të tjera me kërkesë të Bordit dhe Kryeshefit Ekzekutiv, në përputhje me rregulloret e brendshme të kompanisë.
 - Për punën e vet i përgjigjet BD, ndërsa për punën e përditshme i përgjigjet KE-së.
- Kualifikimi:**
- Diplomë të Fakultetit Juridik.
 - Përvojë pune së paku 3 vjeçare, e dëshmuar në fushën e legjislacionit.
 - Të ketë aftësi të komunikimit dhe të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e Kompanisë.
 - Të përmbushë dhe kërkesat e parapara me Kodin e Etikës dhe praktikata e mira.
 - Preferohet njohje e mirë e Gjuhës Angleze.
 - Të mos jetë nën hetime për vepra penale.
- Informata të përgjithshme për kandidatë:**

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Kompanisë.

Procedura e konkurimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, si dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund gjendet në Web-faqe të KMDK-së.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Administratës së KMDK-së.

Afati për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Publik duke filluar nga data : 05.07.2019 deri me datën 03.08.2019 ora 16:00. Email: info@kmdk-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Nr.30/2019-06/1datë14.06.2019

U skladu sa članom 13, stav 1 Statuta Službe bolnice i kliničke bolnice Kosova, član 6 tačka 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o Uredbi o procedurama javnog konkursa, i Preporuku Odbora za izbor pisma br. 1530/3 od 03.07.2019. Generalni direktor SHSKUK izdao je sledeće:

ODLUKA
Za ponavljanje javnog konkursa

- I. Javni konkurs broj 1530, od 14.06.2019, za doktore, specijaliste infektologa UKCK zbog nedovoljnog broja kandidata, traje 15 dana od dana objavljivanja u jednom od medija.
- II. Kadrovski sektor je obavezan da sprovede ovu odluku;
- III. Ova Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

Obrazloženje

omisiya za izbor u skladu sa Odlukom br. 1530/2 od 19.06.2019, tokom pregleda dokumentacije bez nedovoljnog broja kandidata i preporučeno da se nastavi konkurs za 15 dana prema članu 6 tačka 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, još 15 dana, kada se traži veća konkurencija.

Stoga, generalni direktor SHSKUK-a, u skladu sa nadležnostima, u skladu sa važećim zakonom i datom preporukom, dozvoljava ponavljanje javnog konkursa za lekare specijaliste za infektivne bolesti UFCK u narednih 15 dana.

Kao što je gore navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove Odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

Generalni Direktor UBKSK.

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Dr Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë -Ministarstvo Trgovine i Industrije –
Ministry of Trade and Industry

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E KONKURSIT

Vazhdohet konkursi i jashtëm i publikuar me datë 19.06.2019 (Epoka e Re) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, pozita **Zyrtar Multimedial**.

Meqë pas datës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik, afati për pranimin e aplikacioneve për këtë pozitë zgjatet për shtatë (7) ditë kalendarike.

Vazhdimi i konkursit fillon nga: 05.07.2019.

OBAVEŠTENJE ZA PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Produžava se javni konkurs koji je objavljen 19.06.2019 (Epoka e Re) u Ministarstvu Trgovine i Industrije, pozicija: **Multimedijalni Službenik**.

Pošto nakon poslednjeg datuma prijema aplikacija nije postignut prihvatanje balansirano broja prijave sa etničkog aspekta, rok za prijem aplikacija za ovu poziciju produžava se na sedam (7) kalendarskih dana.

Nastavak konkursa počinje od: 05.07.2019.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "XONA E BLINIT" Sh.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810029703 me pronar Ragip Krasniqi, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "XONA E BLINIT" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810029703 Ragip Krasniqi ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "XONA E BLINIT" L.L.C. has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810029703, Ragip Krasniqi the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Shalaj" Sh.p.k. Zallç, Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të elementeve nga betoni (kupëzave, anësorëve, bllokave me struktura) në Zallç komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.07.2019 në ora 11:00 në hapësirat e kompanisë "Shalaj" në Zallç komuna e Istogut, do të organizohet debat publik nga kompania "Shalaj" Sh.p.k. Zallç, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të elementeve nga betoni (kupëzave, anësorëve, bllokave me struktura) në Zallç komuna e Istogut.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Migjeni"- Lubizhde
Komuna: Malishevë
Data: 4.07.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/054 - ESIP/SDG/054-CS/1.3	Trajnim i mësimdhënësve për TIK

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Migjeni"- Lubizhde, Malishevë

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

Trajnim: Trajnim i mësimdhënësve për TIK

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e trajnimeve profesionale:

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e trajnimit profesional (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%)
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuara që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Migjeni"- Lubizhde -Malishevë , më së largu deri më 12.07. 2019.

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Sokol Paçarizi Bajram Bytyçi
Telefoni: 044581906 , 044355392
E-maili: shfmu-migjeni@hotmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Unë, Lorenta Bekteshi, e lindur më 11.07.1993 në Podujevë, e shpalli të pavlefshme diplomën të shkollës së mesme në gjimnazin "Xhevdet Doda" në Prishtinë.
- ▶ Era Postoseli shpallë të pavlefshëm dëftesat e shkollës fillore "Abdyl Frashëri" Prizren.
- ▶ Andis Nallbani shpallë të pavlefshëm dëftesën e klasës 10 "Mehmet Akif" Prizren.
- ▶ "Probiovet" Sh.P.K shpall te pavlefshme certifikaten deklaruese te TV.Sh me numer 330281692 Prizren
- ▶ "Biovet" Sh.P.k shpall te pavlefshme certifikaten deklaruese te TV.Sh me nimer fiskal 601338199 Prizren
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Albulene Bajraktari shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën "Gymnazium Loyola" - Prizren
- ▶ Sami Ademaj shpall te pavlefshme diplomën Shmt "11 Marsi" - Prizren .
- ▶ Arsim Pireci shpall te pavlefshme dëftesat e vitit I ,II Shme "Ymer Prizreni" - Prizren
- ▶ Miftar Shaban Lushaj nga Gjakova, shpall të pavlefshëm diplomën e Masterit të lëshuar nga kolegi "Iliria" në drejtimin: juridik Civil.
- ▶ Mehmet Gashi shpallë të pavlefshëm diplomën e SH.M.T. "11 marsi" Prizren.
- ▶ Shpend Shatri shpallë të pavlefshëm dëftesat e shkollës fillore "Hysni Temaj" Kushnin Has.

Labinot Ahmeti shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr NRB 70487918 me emër DPT "Labi" me seli në Skenderaj.



SHOQATA E TË BURGOSURVE POLITIKË E KOSOVËS DEGA NË DRENAS



Lajmin për vdekjen e parakohshme pas një sëmundje të rëndë për Gani Sylën e morëm me shumë pikëllim dhe gati si lajm të pabesuar, por doli e vërtetë.

Për Gani Sylen, atdhetar, veprimtar i Çështjes Kombëtare, i burgosur politik, luftëtar i Lirisë së Kosovës dhe punëtor i palodhshëm, fjalët janë shumë pak, por kujtimi për të do të jetë i pahar-rueshëm.

Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës - Dega në Drenas
Familjes, farefisit, shokëve dhe shoqeve të idealit, të gjithë atyre që e njoftën dhe punuan me të
iu shprehim ngushëllimet më të sinqerta.

Ky person unikat hyri në trenin e çlirimit të vendit më 1978 dhe nga ai tren kombëtar nuk zbriti
deri më sot, më 04.07.2019.

Lavdi për mot e jetë!
Dheu i Kosovës t'u bëftë i lehtë!

SHBPK-Dega Drenas